Qendra për Arsim e Kosovës
Kosova Education Center
KEC

RAPORTI I PUNËS PËR VITET

2008-2009

Prishtinë, janar 2010

Qendra për Arsim e Kosovës
Kosova Education Center
KEC

Raporti i punës për vitet 2008-2009

Kontakti:
Dukagjin Pupovci
Drejtor ekzekutiv
Qendra për Arsim e Kosovës (KEC)
Kompleksi i Shkollës "Mileniumi i Tretë"
rr. "Isa Kastrati", p.n.
Prishtinë
Tel. 038/244 257, lok. 105
Fax.038/244 257, lok. 109
E-mail: dpupovci@kec-ks.org

Përmbajtja

LISTA E SHKURTESAVE 4
0. HYRJE 5
1. MENDIMI KRITIK GJATË LEXIMIT DHE SHKRIMIT (MKLSH) 7
2. HAP PAS HAPI 10
3. NGRITJA E CILËSISË NË EFH 13
4. SHOQËRIA CIVILE PËR PJESËMARRJE TË SHTUAR NË ARSIM 17
5. KRIJIMI I MJEDISEVE TË SIGURTA , JO TË DHUNSHME DHE HUMANE NË SHOQËRI DHE SHKOLLA 19
6. KOSOVISION CONTEST 22
7. PROMOVIMI I TË DREJTAVE TË FËMIJËS NË FUSHËN E ARSIMIT 25
8. AVANCIMI I PJESËMARRJES DHE PËRFAQËSIMIT TË GRUPEVE TË PAKICAVE ETNIKE NË ARSIM 27
9. PROJEKTI PËR PËRMIRËSIMIN E PJESËMARRJES NË ARSIM II 28
10. EDUKIMI PËR TË DREJTËN SHOQËRORE 30
11. QENDRA PËR PËRSOSMËRI NË MËSIMDHËNIE 31
12. ACCESS MICROSCHOLARSHIP PROGRAM 33
13. MONITORIMI I IMPLEMENTIMIT TË STRATEGJISË RAE 34
14. MENTORIMI I PROJEKTEVE PËR PËRKRAHJE TË ARSIMIMIT TË KOMUNITETEVE RAE 37
15. DHUNA NË MES TË BASHKËMOSHATARËVE 38
16. MONITORIMI I MENAXHIMIT TË FINANCAVE KOMUNALE TË ARSIMIT NË 5 KOMUNA TË KOSOVËS 40
17. AVANCIMI I MËSIMDHËNIES SË HISTORISË 42
18. QASJA TËRËSEKTORIALE NË ARSIM 44
19. WBC-INCO.NET 46
20. INFORMIMI DHE PUBLIKIMET 47
21. SHKOLLA JOPUBLIKE "MILENIUMI I TRETË" 50
22. AKTIVITETE TË TJERA 53
23. PËRFUNDIMI 54

Lista e Shkurtesave

AKK	Asociacioni i Komunave të Kosovës
APREME	Avancimi i Pjesëmarrjes dhe Përfaqësimi të Grupeve të Pakicave Etnike në Arsim
BTD	Trusti Ballkanik për Demokraci
DKA	Drejtoria Komunale e Arsimit
ECLO	Zyra e Ndërlidhëse e Komisionit Evropian
EDSH	Edukimi për Drejtësinë Shoqërore
EFH	Edukimi për fëmijërinë e hershme
EIDHR	Istrumenti evropian për demokraci dhe të drejta të njeriut
HPH	Hap pas Hapi
IDEP	Programi i Zhvillimit Institucional të Arsimit
IP	Institucionet parashkollore
IPA	Istrumenti për para anëtarësim
ISSA	Shoqata Ndërkombëtare e Hap pas Hapit
KAHCR	Shoqata Kosovare për të Drejtat e Njeriut dhe Fëmijës
KEC	Qendra për Arsim e Kosovës
KFOS	Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MKLSH	Mendimi Kritik gjatë Leximit dhe Shkrimit
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
NEPC	Rrjeti i Qendrave të Politikave Arsimore
OSI	Instituti për Shoqëri të Hapur
QPM	Qendra për Përsosmëri të Mësimdhënies
SBASHK	Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës
SWAP	Qasja tërësektoriale
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijë
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë

0. HYRJE

Në fillim të vitit 2008 filloi punën përbërja e re e Kuvendit të Kosovës e dalë nga zgjedhjet e përgjithshme të nëntorit të vitit 2007, ndërsa u zgjodh edhe Qeveria e re, e cila arsimin e radhiti në mesin e prioriteteve të saj. Shpallja e pavarësisë së Kosovës, më 17 shkurt 2008 dhe pranimi i Planit të Ahtisaarit nga institucionet e Kosovës, kishin reflektime edhe në fushën e arsimit, në radhë të parë në bartjen e plotë të kompetencave nga autoritete ndërkombëtare të UNMIK-ut tek Qeveria e Kosovës, por edhe në bartjen e kompetencave nga niveli qendror në atë lokal. Në fakt, Ligji për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës, i aprovuar në qershor të vitit 2008, i fuqizon shumë komunat në kuptim të administrimit të sistemit të arsimit, ndërsa Ministrisë së Arsimit të Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), i mbetet të ushtrojë funksionet tipike shtetërore siç janë: politikbërja, përcaktimi i planit dhe programit mësimor, përcaktimi i standardeve për cilësi, inspektimi, etj. Megjithatë, kalimi i kompetencave nga niveli qendror në atë lokal është akoma një proces në zhvillim e sipër, ndërsa vështirësi të madhe paraqet kapaciteti i kufizuar i komunave për t'i ushtruar përgjegjësitë e reja.

Vitet 2008 dhe 2009 i shënoi një ringjallje e interesimit të donatorëve për të përkrahur zhvillimin e sistemit të arsimit. Meqë orientimi ishte që përkrahja të jepet për implementimin e agjendës së Qeverisë, në periudhën mars-qershor 2008 u hartua një studim fisibiliteti për mundësinë e zbatimit së qasjes tërësektoriale (SWAp) në sistemin e arsimit. Ky studim përcaktoi një hartë të rrugës për implementimin e SWAp-it në arsim, duke rekomanduar hartimin e një strategjie tërësektoriale për sistemin e arsimit, por edhe ndërtimin e kapacitetit për planifikim më të mirë, në veçanti në fushën e financave të arsimit.

Pas publikimit të studimit, filloi implementimi i një varg projektesh që kishin për qëllim ofrimin e ndihmës për implementimin e aspekteve të ndryshme të SWAp-it në arsim. Kështu, Banka Botërore filloi implementimin e Projektit për Zhvillimin Institucional (IDEP), ndërsa me financimin e Bashkimit Evropian filloi implementimi i projektit që është në përkrahje të drejtpërdrejtë të implementimit të SWAP-it në arsim, në veçanti në fushën e ndërtimit të kapacitetit, trajnimit të mësimdhënësve dhe zhvillimit të kurrikulit.

Me fillimin e zbatimit të instrumentit të aderimit IPA të Komisionit Evropian dhe orientimin e disa donatorëve të tjerë për financimin e projekteve përmes kontratave të shërbimit, u imponua nevoja që KEC të sprovohet edhe në këtë fushë që është në harmoni të plotë me strategjinë e organizatës. Kështu, si pjesë e konsorciumit të udhëhequr nga Cambridge Education Ltd., KEC filloi implementimin e projektit "Përkrahja për qasjen tërësektoriale në arsim (SWAp)" të financuar nga IPA 2008, një kontratë shërbimi trevjeçare me vlerë rreth 2.8 mil. EUR. Ndërkaq, KEC realizoi edhe dy kontrata më të vogla shërbimi me financues të tjerë dhe është në proces të aplikimit për një tjetër.

Po ashtu, KEC ishte mjaft i suksesshëm edhe në realizimin e kontratave të granteve, në veçanti të atyre që financohen nga Bashkimi Evropian. Në vitet 2008 dhe 2009 u paraqitën gjithsej 5 aplikacione, prej të cilave dy u përzgjodhën për financim, ndërsa një është në listën rezervë. Në një rast KEC është koordinator i një projekti rajonal ku marrin pjesë organizata partnere nga gjashtë vende të Rajonit. Ndërkaq, fondet e shkollës "Mileniumi i Tretë" vazhdojnë të përdoren për ta përkrahur arsimin publik.

KEC akoma vazhdon të ndjekë planin strategjik të zhvilluar në vitin 2005, në kohën e kalimit të KEC nga një organizatë tipike joqeveritare që menaxhon fonde të donatorëve në organizatë që i përgjigjet kërkesave të donatorëve dhe kërkesave të tregut duke ofruar shërbime të cilësisë së lartë për komunitetin arsimor dhe palët me interes. Plani strategjik përcaktoi vizionin dhe misionin e ri të KEC:

Vizioni i KEC është *ndërtimi i një sistemi efikas dhe gjithëpërfshirës të arsimit që i kontribuon zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror të vendit, duke aftësuar qytetarët për të nxënë gjatë gjithë jetës dhe për pjesëmarrje aktive në jetën demokratike*.

Misioni i KEC është *zhvillimi i kapacitetit për avancimin e sistemit të arsimit, përmes ofrimit të shërbimeve dhe të burimeve të cilësisë së lartë, si dhe përmes bashkëpunimit aktiv me të gjitha palët me interes në vend dhe jashtë tij*.

Objektivat e përcaktuara strategjike të KEC janë:

1. Të përfshihen në programe të aftësimit agjentët e ndryshimeve pozitive të sistemit të arsimit, si dhe subjektet e zhvillimit të qëndrueshëm shoqëror dhe ekonomik;
2. Të sigurohet qarkullimi funksional i informacionit për qasje inovative dhe për ndryshime në arsim dhe në shoqëri;
3. Të ndërtohen kapacitete të brendshme për t'iu përgjigjur kërkesave aktuale të tregut;
4. Të sigurohen parakushtet themelore për ushtrimin dhe për zgjerimin e veprimtarisë jofitimprurëse të KEC;
5. Të ndërtohen partneritete të qëndrueshme me organizata dhe me institucione vendore dhe ndërkombëtare.

Për çdo objektivë strategjike janë definuar masat (veprimtaritë), si dhe është hartuar një kalendar i veprimtarive me bartës të detyrave dhe afate për kryerjen e tyre. Gjithashtu, është ndërtuar një sistem për monitorimin dhe për vlerësimin e strategjisë.

Disa nga programet dhe projektet kryesore të KEC që janë zbatuar gjatë viteve 2008 dhe 2009 janë:

- Zhvillimi i mendimit kritik gjatë leximit dhe shkrimit (MKLSH)
- Hap pas Hapi (HpH)
- Shoqëria Civile për Pjesëmarrje të Shtuar në Arsim
- Krijimi i mjediseve të sigurta, jo të dhunshme dhe humane në shoqëri dhe shkolla
- Kosovision Contest
- Promovimi i të drejtave të fëmijës në fushën e arsim
- Avancimi i pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të grupeve të pakicave etnike në arsim
- Projekti për Përmirësimin e Pjesëmarrjes në arsim II
- Access Microscholarship Program
- Avancimi i mësimdhënies së historisë
- Qasja tërësektoriale në arsim, etj.

1. MENDIMI KRITIK GJATË LEXIMIT DHE SHKRIMIT (MKLSH)

Programi "Mendimi Kritik gjatë Leximit dhe Shkrimit"(MKLSh) është duke u zbatuar me sukses në Kosovë që nga viti 2000. Gjatë periudhës 2000/08, në kuadër të këtij programi janë arritur shumë rezultate. Disa nga ato janë:

Aftësimi profesional i mësimdhënësve për zbatimin e metodologjive bashkëkohore të mësimdhënies dhe të nxënit në klasat e tyre.

Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) në bashkëpunim me shumë donatorë si OSI, KFOS, MAShT, UNICEF, Banka Botërore etj. ka arritur që deri në fund të vitit 2008 të ofrojnë mundësi për trajnimin e 6,101 mësimdhënës të lëndëve dhe niveleve të ndryshme të shkollimit në mbarë Kosovën. Në mesin e tyre, 181 mësimdhënës kanë përfituar nga angazhimi vullnetarë i trajnerëve, ndërsa 228 me participim. Nga numri i përgjithshëm i të trajnuarve janë certifikuar 273 mësimdhënës për nivelin e dytë, 62 trajnerë dhe 5 certifikues të Programit të MKLSH-së.

Mundësia e zbatimit të teknikave dhe strategjive të programit të MKLSh-së në klasa në kushtet ekzistuese ka bërë që interesimi i mësimdhënësve për të vijuar këtë program të jetë jashtëzakonisht i madh. Disa grupe të mësimdhënësve duke vlerësuar përparësinë e zbatimit të teknikave të këtij programi në arritjen e rezultateve në klasë kanë vijuar programin e trajnimit me participim.

Publikimi i udhëzuesve dhe librave që ndihmojnë zbatimin e Programit të MKLSH-së në klasa

KEC i ofron secilit pjesëmarrës në trajnim udhëzuesit 1-8 të programit të MKLSh-së, planin ditor dhe standardet për certifikim. Këto materiale ndihmojnë mësimdhënësit në zbatimin e metodologjisë së MKLSh-së në klasat e tyre, jo vetëm gjatë kohës së trajnimit, por edhe pas përfundimit të programit të trajnimit. Ndërsa standardet i udhëzojnë mësimdhënësit të përgatiten për nivelet e ndryshme të certifikimit, të cilat janë të përcaktuara në kuadër të MKLSh-së.

Për të ndihmuar aftësimin profesional të mësimdhënësve në zbatimin e metodologjisë së MKLSh-së në klasat e tyre, KEC ka publikuar edhe libra të tjerë si p.sh.

- Modele të mësimdhënies sipas strukturës ERR,
- Strategji të mësimdhënies dhe të nxënit në klasat mendimtare,
- Zhvillimi i shprehive të të menduarit,
- Të nxënit ndërveprues, etj.

Objektivat dhe aktivitetet e programit – Synimet e përgjithshme të Programit të MKLSh-së janë:

- T'i kontribuojë themelimit të një sistemi për trajnimin e mësimdhënësve me metodologjinë bashkëkohore të mësimdhënies dhe të nxënit,
- Të ndihmojë mësimdhënësit në krijimin e një atmosfere miqësore të të nxënit në klasa.

Të gjitha strukturat arsimore të nivelit qendror dhe komunal pranojnë se programi i MKLSh-së është programi më i strukturuar për zhvillimin profesional të mësimdhënësve. Kjo bazohet në faktin se MAShT dhe DKA e komunave të ndryshme kanë bashkë financuar trajnimin e mësimdhënësve në kuadër të programit të MKLSh-së. Po ashtu, metodologjia që përdoret në kuadër të Programit të MKLSh-së ka ndihmuar dhe përgatitjen e programeve të tjera të trajnimit për mësimdhënës, siç janë:

- Edukimi kundër korrupsionit,
- Të drejtat e fëmijës,
- Strategjitë e reja të mësimdhënies të mësimdhënies dhe të nxënit,
- Strategjitë të reja të mësimdhënies në lëndën e matematikës dhe të biologjisë, etj.

Zbatimi me sukses i teknikave dhe strategjive në klasa ka ndihmuar mësimdhënësit që të krijojnë një atmosferë miqësore në mes të nxënësve gjatë procesit mësimor. Kjo vërehet gjatë procesit të monitorimit që realizojnë trajnerët në klasa, si dhe në organizimin e ekspozitave të ndryshme me punimet e fëmijëve të realizuara me teknikat e MKLSh-së.

Të arriturat kryesore të programit në vitin 2007 – Gjatë vitit 2009, KEC ka vazhduar trajnimin e 296 mësimdhënësve, të cilët kanë filluar trajnimin në tetor të vitit 2008, ka trajnuar dhe certifikuar 255 mësimdhënës, si dhe ka përfshirë në trajnim 120 mësimdhënës dhe 20 drejtorë të shkollave.

Për 296 mësimdhënësit që kanë filluar trajnimin në tetor të vitit 2008, gjatë vitit 2009 janë:

- Organizuar 4 seminare, 2 monitorime dhe 2 takime gjysmë ditore për 224 mësimdhënës në mbarë Kosovën,
- Organizuar 3 seminare, një monitorim dhe një takim gjysmë ditor për 36 mësimdhënës, të cilët janë trajnuar në bashkëpunim me Qendrën Didaktike në Gjakovë,
- Organizuar 5 seminare, 2 monitorime dhe 2 takime gjysmë ditore për 36 mësimdhënës të komunës së Podujevës, të cilët kanë vijuar trajnimin me participim.

Gjatë vitit 2009, KEC në bashkëpunim me Bankën Botërore kanë organizuar programin e trajnimit "Strategji të reja të mësimdhënies dhe të nxënit" të bazuar në 6

module të programit të MKLSh-së për 217 mësimdhënës të komunave të Prizrenit dhe të Mitrovicës. Të gjithë mësimdhënësit e përfshirë në këtë program kanë participuar financiarisht për të vijuar edhe 2 seminare të tjerë dhe në këtë mënyrë kanë fituar të drejtën për t'u certifikuar për pjesëmarrje në kuadër të programit të MKLSh-së.

KEC në bashkëpunim me Drejtorinë Komunale të Arsimit në Obiliq ka organizuar programin e trajnimit për 38 mësimdhënës të Komunës së Obiliqit. Të gjithë mësimdhënësit kanë vijuar me rregull programin e trajnimit dhe janë certifikuar më 19 dhjetor 2009.

Ndërsa, për 120 mësimdhënës dhe 20 drejtorë që kanë filluar trajnimin në tetor të vitit 2009, deri më tash janë:

- Organizuar 2 seminare për 120 mësimdhënës të komunave Prishtinë, Pejë, Gjilan dhe Ferizaj, si dhe 2 seminare për 20 drejtorë të shkollave fillore dhe të mesme të ulëta të komunës së Prishtinës dhe të Obiliqit.

Pasqyra e realizimit të trajnimeve sipas donatorëve gjatë vitit 2009 është:

Nr.	Partnerët	Numri i mësimdhënësve	Numri i orëve
1.	Banka Botërore	217	26,040
2.	Podujeva (participim)	36	3,168
3.	DKA Obiliq	38	4,560
4.	KEC (që kanë përfunduar)	260	18,000
5.	KEC (të përfshirë)	140	4,480
		Gjithsej	**56,248**

Nga raportet e trajnerëve shihet se trajnimet janë mbajtur në çdo qendër sipas orarit dhe agjendës së paraparë. Vështirësia kryesore e realizimit të programit të trajnimit është monitorimi i mësimdhënësve. Pjesëmarrja në trajnim e mësimdhënësve nga shumë shkolla e vështirëson procesin e monitorimit.
Gjatë vitit 2009, bordet lokale të Programit të MKLSh-së në bashkëpunim me KEC-in kanë certifikuar 9 mësimdhënës për nivelin e dytë duke shtuar numrin e mësimdhënësve të certifikuar në 273.

Më poshtë është dhënë numri i të certifikuarve për pjesëmarrje sipas viteve:

Viti	Të trajnuar
2000-01	31
2001-02	350
2002-03	1,080
2003-04	452
2004-05	1,225
2005-06	1,325
2006-07	97
2007-08	990
2008-09	551
Gjithsej	**6,101**

Të certifikuar si mësues të MKLSh: 273.
Të certifikuar si trajnerë të MKLSh: 62.
Programin janë duke e vijuar 120 mësimdhënës dhe 20 drejtorë të shkollave.

Sugjerimet për përmirësim në të ardhmen – Mësimdhënësit janë shumë të interesuar të vijojnë programin e trajnimit. Interesimin e madh të mësimdhënësve për të vijuar këtë program e pranojnë dhe përfaqësuesit e institucioneve arsimore qendrore dhe komunale, të cilët dëshmojnë se vazhdimisht pranojnë kërkesa nga drejtorët e shkollave dhe mësimdhënësit për të vijuar këtë program të trajnimit.

Duke pasur parasysh këtë, KEC duhet të bashkëpunojë më shumë me MAShT, DKA dhe donatorë të tjerë për të mundësuar përfshirjen sa më të madhe të mësimdhënësve në trajnim, si dhe për të ruajtur interesimin e mësimdhënësve për zhvillim të vazhdueshëm profesional. Po ashtu, KEC duhet të bashkëpunojë me MAShT për të organizuar monitorimin e implementimit të programit të MKLSh-së nga mësimdhënësit që janë certifikuar në vitet e mëparshme.

2. HAP PAS HAPI

Hyrje – Hap pas hapi është program me në qendër fëmijën i cili afirmon metodologji të re të mësimdhënës. Programi ka për qëllim që edukatorët dhe mësuesit të përfitojnë në ngritjen e tyre profesionale, të kenë qasje në metoda të reja të punës në klasë në bashkëpunim me familje dhe komunitet, në informacion të ri për edukimin në fëmijërinë e hershme si dhe në shkëmbim përvojash mes vete dhe me kolegët e tyre brenda dhe jashtë vendit. Fëmijët përfitojnë në pozitën e tyre afirmative në klasë, janë aktiv, kanë liri të të shprehurit dhe respektohen interesat dhe dëshirat e tyre

Programi Hap pas hapi deri më tani ka trajnuar një numër të madh të edukatorëve të institucioneve parashkollore, mësuesve të shkollave fillore, drejtorëve, pedagogëve të këtyre institucioneve, profesorëve të fakultetit, studentëve etj.

Gjatë periudhës raportuese janë trajnuar 226 edukatorë dhe 1,189 mësues të shkollave fillore, për metodologjinë Hap pas hapi. Në trajnime po ashtu kanë marrë pjesë edhe një numër i pedagogëve, drejtoreve të institucioneve ku realizohet programi, si dhe studentëve të profileve edukative.

Objektivat dhe aktivitetet e Programit

1. Ngritja e kapacitetit dhe qëndrueshmërisë së rrjetit të trajnerëve dhe mentorimit.
2. Krijimi i rrjetit të komunitetit, mësuesve, institucioneve parashkollore dhe shkollave të programit Hap pas hapi.
3. Përkrahje efektive e MASHT-it për zhvillimin e politikave për fëmijërinë e hershme.
4. Forcimi i kapacitetit drejtues të ekipit të programit Hap pas hapi.
5. Ngritja e kualitetit të punës në klasat e programit Hap pas hapi.
6. Pjesëmarrja e minoriteteve në trajnimet e programit Hap pas hapi.

7. Zgjerimi i rrjetit të klasave të programit Hap pas hapi në klasat parafillore.
8. Zgjerim i rrjetit të klasave të programit Hap pas hapi në shkolla fillore.

Të arriturat kryesore të Programit.– Të arriturat kryesore të Programit "Hap pas Hapi" në vitin 2009 janë:

1. Trajnimet dhe punëtoritë e realizuara

1.1 Kopshtet dhe klasat parafillore

Trajnimi avancues i metodologjisë "Hap pas hapi"për edukatorë të institucioneve parashkollore që punojnë me grupmosha 3-6 u organizua në periudhën 19-23 janar në bazë të kërkesave që dolën nga monitorimi i punës së edukatoreve kryesisht në Rajonin e Prishtinës.

Në bashkëpunim me Komunën e Prishtinës, Drejtorinë Komunale për Arsim, është realizuar projekti për aftësimin të edukatorëve të Institucioneve parashkollore të Prishtinës për dramatizim. Ky projekt u realizua me 4 ditë trajnimi dhe 2 ditë punë praktike. Gjatë pjesës teorike të gjitha institucionet janë përcaktuar për një skenar, skenë, dhe kostume të cilat më pas i kanë përgatitur deri te finalizimi i shfaqjes. Ndërsa gjatë pjesës praktike kanë realizuar shfaqje së bashku me fëmijët para audiencës, që edhe ishte kusht për certifikime.

Grupi I - trajnimi Puna praktike	7,8,21,22 nëntor 18,17 dhjetor	I.P.: Fatosat, Buzëqeshja, Xixëllonjat
Grupi II - trajnimi Puna praktike	5,6,12,13,/12 21,22 dhjetor	I.P. Gëzimi Ynë, Ardhmëria

Gjatë janarit të vitit të ardhshëm do të organizohet edhe trajnimi për grupin e tretë, kështu që të gjitha institucionet parashkollore publike të Prishtinës do të përfshihen në këtë trajnim.

1.2. Shkolla fillore

Gjithnjë e më tepër po shtohet interesimi nga ana e mësimdhënësve të shkollave fillore që të përfshihen në trajnimet e metodologjisë "Hap pas hapi". Për shkak të pamundësisë së monitorimit të mësimdhënësve në praktikë dhe me qëllim të përcjelljes së realizimit të objektivave të metodologjisë "Hap pas hapi", të gjithë pjesëmarrësit kanë pasur obligim të realizojnë planifikime të punës së tyre sipas metodologjisë përkatëse, një muaj pas përfundimit të trajnimit. Planifikimet i kanë përgatitur dhe realizuar varësisht nga niveli i trajnimit, nga një ditore deri te ato javore dhe mujore. Prezantimet e realizimit të planifikimit janë bërë para grupit, e kjo ishte kusht për certifikim. Kjo metodë ndihmon shume përcjelljen e realizimit të programit në klasa si dhe është mundësi shumë e mire për shkëmbimin e përvojave.

Trajnimet e metodologjisë "Hap pas hapi" të organizuara për mësimdhënësit nga klasa e parë deri të katërtën për shkollat publike gjatë vitit 2009 janë:

Pejë- grupi I	10,11,12 janar	klasa e dytë
Pejë- grupi II	17,18,24 janar	klasa e dytë
Pejë- grupi III	17,18,24 janar	klasa e dytë
Prizren	2,3,4 shkurt	klasa e tretë
Prishtinë I	25,26,27 mars	klasa e dytë
Gjakovë	22,23,24 mars	klasa e katër
Gjakovë	24,25,26 mars	klasa e katërt
Prishtinë	18,19,20 prill	klasa e tretë
Prishtinë	17,18,19 prill	klasa e katërt
Istog	14,15,21,22,24 prill	klasa e parë avancues
Prishtinë	6,7,8 qershor	klasa e katërt
Prizren	13, 14, 15 qershor	klasa e dytë
Gjakovë	5,6,12,13,14 shtator	klasa e parë fillestar

Dy grupe të komuniteteve RAE u përfshin në trajnime për klasën e parë sipas metodologjisë "Hap pas hapi". Kjo u realizua në bashkëpunim me Ballkan Sunflowers Pjesëmarrësit në këto trajnime ishin tutorët dhe fasilitatorët të cilët punojnë aktivitete jashtëkurrikulare me fëmijët e këtyre komuniteteve, por që fokus kanë ndihmesën e kryerjes së detyrave shkollore dhe përvetësimit të njohurive. Trajnimet ishin të modifikuara për shkak se pjesëmarrësit nuk kishin përgatitje profesionale paraprake për punë me këta fëmijë.

Trajnimi i parë ishte vazhdimësi e grupit që mori pjesë edhe vitin e kaluar. Edhe pse i modifikuar, pjesëmarrësit janë certifikuar për trajnimin avancues të klasës së parë. Të gjithë pjesëmarrësit ishin të komunitetit ashkali të cilët punojnë në qendër në Fushë Kosovë

Grupi i dytë që po ashtu u organizua në Fushë Kosovë. Pjesëmarrësit ishin të komunitetin rom të cilët punojnë në Graçanicë, ky trajnim u mbajt në gjuhën serbe.

Fushë Kosovë	29,30,1 qershor, 1,2,3 korrik	klasa e parë avancues
Fushë Kosovë	6,7,8,10,11, nëntor	klasa e parë fillestar

2. Ngritja e kapacitetit të mentorëve dhe trajnerëve

Tani në rrjetin e Hap pas hapit ekziston një ekip mjaft i profilizuar për monitorim. Për shkak të rritjes konstante të klasave të cilat punojnë me metodologjinë "Hap pas hapi" dhe pamundësisë së monitorimit të mësimdhënësve dhe edukatorëve në praktikë është gjetur një modalitet tjetër. Pjesëmarrësit në trajnime, duhet të paraqesin planin e planifikimit të punës së tyre për një periudhë të caktuar, para grupit, trajnerëve apo monitorëve. Kjo ndihmon përcjelljen e realizimit të programit "Hap pas hapi" në praktikë.

3. Monitorimi i punës në klasat të cilat punojnë sipas metodologjisë Hap pas hapi:

Monitoruesit e programit kanë monitoruar në bazë të standardeve të programit HpH dhe instrumenteve të reja të cilat kanë filluar të përsosen në vitin 2007, gjë që ndihmon shumë edhe në grumbullimin e informatave nga terreni. Kjo formë e re e monitorimit ka ndihmuar mjaft në ngritjen e cilësisë së punës në klasë.

Në përfundim të çdo raundi të monitorimit është bërë takimi me monitorues ku janë sjellë format e monitorimit, është diskutuar për monitorimet e bëra dhe është bërë plani i vizitave për raundin tjetër.

4. Rrjeti i institucioneve parashkollore dhe shkollore

Takimet e rrjetit të "Kontakt personave" të institucionet parashkollore nuk kanë qenë shumë të shpeshta gjatë periudhës raportuese. Këto takime kanë qenë me karakter të punëtorisë me tema të caktuara paraprakisht. Po ashtu këto takime kanë qenë rast i mirë për shkëmbimin e ideve në mes të I.P. Në vitin 2009 është vazhduar me iniciativën e vizitës së kolegëve gjatë procesit mësimor brenda shkollës dhe I. P. me qëllim të shkëmbimit të ideve..

Sugjerimet për përmirësim në të ardhmen.– Vërehet interesim nga ana e mësimdhënësve të cilët janë përfshirë në trajnimet e metodologjisë "Hap pas hapi" të marrin pjesë në trajnimet për monitorim, ku jepen informata më të detajuara rreth standardeve të programit "Hap pas hapi". Kjo ka dalë si kërkesë pas aftësimit të drejtorëve për monitorimin e mësimdhënësve. Duke pasur parasysh se kjo edhe ndihmon në ngritjen e cilësisë në klasë, është mirë që gjatë viteve të ardhshme të gjenden mundësi për përfshirjen e tyre në këto lloj trajnime.

3. NGRITJA E CILËSISË NË EFH

Hyrje – Pavarësisht se sa është investuar për të përmirësuar mësimdhënien gjatë këtyre viteve, shumë pak është bërë për krijimin e sistemit të sigurimit të cilësisë së mësimdhënies tek ne. Të gjithë mësimdhënësit kanë nevojë për sisteme përkrahje për zhvillimin e tyre profesional dhe për ndryshimin e praktikës së tyre

Ky projekt ka për qëllim të kontribuoi në sigurimin e mekanizmit për ngritjes e cilësisë në edukimin e fëmijërisë së hershme, duke aftësuar drejtorët e institucioneve parashkollore dhe të shkollave fillore, pedagogët dhe zyrtarët e arsimit për procesin e monitorimit të edukatorëve/mësuesve me një instrumenti të unifikuar, që do të mundësonte vlerësimin sa me objektiv.

Disa nga arsyet që kanë çuar në realizimin e një projekti të tillë janë:

- Mungesa e sistemit të monitorimit të mësimdhënësve, në nivel të institucionit;
- Mungesa e pedagogëve;
- Shumë nga drejtorët nuk janë të aftësuar për ofrimin e përkrahjes profesionale – nuk janë të profileve pedagogjike;
- Shume trajnime dhe aftësime, por nuk ka analiza të ndikimit në procesin e punës te mësimdhënësit.

Projekti është realizuar gjatë vitit 2009 nga ekipi i Programit "Hap pas Hapi" me përkrahjen financiare të Fondacionit "Soros".

Objektivat dhe aktivitetet e Projektit.- Në bazë të nevojave të identifikuara nga praktika në institucionet arsimore në Kosovë si dhe nevojave të vetë Programit "Hap pas Hapi", janë paraparë këto objektiva dhe aktivitete:

1. Kontributi në zhvillimin e mekanizmit për sigurimin e cilësisë në sistemin e Zhvillimit të Edukimin e Fëmijërisë së Hershme.
    - Krijimi i metodologjisë së monitorimit dhe instrumentit vlerësues.

2. Krijimi i rrjetit të profesionistëve që përkrahin mësimdhënien e bazuar me fëmijën në qendër dhe mësimdhënien cilësore, duke monitoruar/vëzhguar dhe këshilluar mësimdhënësit.
    - Krijimi i modulit të trajnimit
    - Trajnimi i 300 pjesëmarrësve për monitorim
    - Monitorimi në praktikë
    - Analiza e procesit të monitorimit

Të arriturat kryesore të Projektit.

1. <u>Krijimi i metodologjisë së monitorimit dhe instrumentit vlerësues</u>

Grupi prej 10 ekspertëve (drejtorë të institucioneve shkollore dhe parashkollore, inspektorë dhe zyrtarë të arsimit, mësimdhënës dhe bashkëpunëtorë të KEC) gjatë punëtorisë 4-ditore ka hartuar instrumentin e vlerësimit të monitorimit. Për bazë janë marr standardet për mësues të programit "Hap pas hapi" të cilat i janë përshtatur kontekstit kosovar. Këto instrumente përdoren për vlerësimin e punës së mësimdhënësve nga ana e drejtorit për qëllime të shkollës. Ky instrumenti i vlerësimit është lehtë i përdorshëm, ka tregues të vëzhgueshëm që duhet notuar me nota numerike, që e bëjnë më të qarte vlerësimin.

Instrumenti i monitorimit të cilin pjesëmarrësit e morën në trajnim duhet të përdoret edhe si:

- dokument që i shërben arkivit të drejtorit me informata të mjaftueshme rreth, performancës së mësimdhënësit,

- mundësi për mësimdhënësit për zhvillim profesional.
- mundësi për të përcjell punën e drejtorëve nga ana e zyrtarëve dhe inspektorëve .

2. Krijimi i modulit të trajnimit

Një grup i trajnerëve të programit "Hap pas hapi" ka krijuar modulin 3-ditor të trajnimit për monitorimin e mësimdhënësve. Instrumenti i vlerësimit ishte bazë e përgatitjes së këtij moduli.

3. Trajnimet e realizuara

Qëllim i trajnimeve ishte aftësimi i drejtorëve të shkollave fillore dhe institucioneve parashkollore për vlerësimin e mësimdhënësve me anë të instrumentit të unifikuar për zhvillimin e EFH. Ky instrument i vlerësimit, drejtorëve u ndihmon të jenë sa më objektiv dhe argumentues gjatë monitorimit..

Në trajnimin 3-ditor u përfshinë më se 300 pjesëmarrës nga këto komuna: Prishtinë, Ferizaj, Prizren, Gjakovë, Gjilan, Mitrovicë, dhe Skenderaj. Në Pejë me kërkesën e Drejtorisë Komunale të Arsimit u realizua edhe trajnimi i dytë, në këtë grup kishte edhe drejtor shkollash nga Istogu e Klina. Zyrtarët dhe inspektorët e arsimit nga këto komuna shprehën dëshirë të jenë pjesë e këtyre trajnime ashtu që për ta u organizua një trajnim i veçante. Po ashtu një grup i veçantë u organizua për drejtorët e Institucioneve Parashkollore.

Trajnimet u zhvilluan sipas këtij orari:

Vendi	*Datat*
Prishtinë	21,22,23 gusht
Pejë I	30 gusht dhe 1,2 shtator
Pejë II	26,27,28 shtator
Gjakovë	11,12,13 shtator
Prizren	11,12,13 shtator
Skenderaj	16,17,18 shtator
Ferizaj	25,26,27 shtator
Mitrovicë	3,4,5, tetor
Gjilan	30,31 tetor dhe 1 nëntor
Zyrtarët dhe inspektorët	5,6,7 tetor
Drejtorët e I.P.	12,13,14 tetor

4. Monitorimi në praktikë

Të gjithë pjesëmarrësit kanë marrë pjesë edhe në monitorim në praktikë 2-3 javë pas trajnimit, që ishte edhe kusht për certifikim. Çdo grup përcaktonte shkollën dhe së bashku realizohej monitorimi i parë në çifte në një klasë dhe, pas 2-3 jave, i dyte me nga 6 veta. Çdo grup në fund të ditës së dytë të monitorimit kishte një punëtori me qëllim të shkëmbimit të përvojave dhe ideve që dolën si rezultat i kësaj praktike. Monitorimet janë realizuar sipas orarit vijues:

Vendi	Monitorimi i parë	Monitorimi i dytë
Prishtinë	30 shtator	14 tetor
Pejë I	24 shtator	20 tetor
Pejë II	9 tetor	23 tetor
Gjakovë	5 tetor	23 tetor
Prizreni	15 tetor	29 tetor
Skenderaj	15 tetor	29 tetor
Ferizaj	19 nëntor	3 dhjetor
Mitrovicë	20 nëntor	5 dhjetor
Gjilan	26 nëntor	4 dhjetor
Zyrtarët dhe inspektorët	21 tetor	
Drejtorët e I.P.	11 nëntor	25 nëntor

5. Analiza e procesit të monitorimit

Gjatë çdo monitorimi si dhe gjatë takimeve të ndryshme të organizuara me pjesëmarrësit janë marr informata dhe ide për praktikën e shfrytëzimit të instrumentit për monitorim:

- Mundësia që të mos vlerësohen të gjitha standardet përnjëherë do të lehtësonte monitorimin
- Notat e vlerësimit (1-4) të ndryshohet ashtu që të shtohet edhe një note vlerësuese 1-5. Ky ndryshim do të mundësonte ndryshimin e vlerësimit në përqindje
- Ndryshime në përmbajtja e disa fjalive (p.sh. largimi i rrethanorit – çdo ditë)
- Terminologjia në instrumentin të përshtatet edhe për parashkollorët (mësimdhënës/edukator, klasë/dhomë,…)
- Të organizohen trajnime edhe për personat që monitorohen
- Të hartohet instrumenti dhe të organizohen trajnime për monitorimin e mësimdhënësve lëndorë.

Rezultatet e trajnimeve, instrumenti i vlerësimit të monitorimit dhe këto ndryshime u paraqitën në tryezën e rrumbullakët të organizuar me datën 13 dhjetor 2009, ku morën pjesë përfaqësues të MAShT, zyrtarë dhe inspektorë te arsimit, drejtorë te shkollave fillore dhe të institucioneve parashkollore, si dhe mësimdhënës dhe edukatorë. Në këtë tryezë përvojat e monitorimit të performancës së mësimdhënësve në Slloveni i prezantoi Tatjana Vonta nga Institutit Pedagogjik, si the Aija Tuna nga Asociacioni Ndërkombëtar i Hap pas Hapit-ISSA.

4. SHOQËRIA CIVILE PËR PJESËMARRJE TË SHTUAR NË ARSIM

Hyrje.– Ideja e projektit Shoqëria Civile për Pjesëmarrje të Shtuar në Arsim ka lindur nga fakti se Kosova duhet të bëjë përparim domethënës në arritjen e njërit nga tetë Objektivat Zhvillimore të Mileniumit, të nxjerra nga Deklarata e Mileniumit e KB – arsimi fillor Universal. Pasi që Kosova e ka nivelin më të lartë të papunësisë dhe përqindjen më të lartë të rinisë në Evropë, ajo duhet t'i drejtojë përpjekjet e saj drejt zhvillimit të burimeve njerëzore në mënyrë të barabartë për të gjitha grupet në Kosovë. Vijimi i përgjithshëm i arsimit fillor dhe ngritja e dukshme në vijim në arsimin parafillor janë çështje themelore për ngritjen e nivelit të arsimimit në vend. Fokusi kryesor duhet të jetë në grupet e margjinalizuara, të cilat kanë nevojë për ndihmë për të qenë në hap me pjesëtarët e tjerë të shoqërisë, duke i përfshirë këtu fëmijët nga shtresat e varfra, fëmijët me nevoja të veçanta dhe grupet e caktuara minoritare (romët, ashkalitë dhe egjiptasit).

Projekti me kohëzgjatje prej 18 muaj dhe me fond prej 350,000 EUR është realizuar në periudhën janar 2007-gusht 2008 në partneritet me Sindikatën e Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK), me Shoqatën Kosovare për të Drejtat e Njeriut dhe të Fëmijës (KAHCR) dhe me Shoqatën Ndërkombëtare të Hap pas Hapi (ISSA), ndërsa është financuar nga Komisioni Evropian.

Objektivat dhe aktivitetet e Projektit. – Objektiva e përgjithshme e projektit është

> *Të kontribuohet në ndërtimin e një sistemi arsimor gjithëpërfshirës që promovon qasje të barabartë në arsimin cilësor dhe modelon respekt për diversitet dhe drejtësi shoqërore*

Objektiva specifike është

> *Të mobilizohen burimet vendore për pjesëmarrje të shtuar të fëmijëve nga grupet e margjinalizuara në arsimin parashkollor dhe fillor duke e ngritur kapacitetin e organizatave të shoqërisë civile për tu angazhuar në bashkëpunim me prindërit, shkollat, autoritetet lokale dhe qendrore*

Aktivitetet kyçe të projektit janë

- Ndërtimi i kapacitetit organizues dhe menaxhues të organizatave partnere
- Hartimi i strategjisë për bashkëpunim të Rrjetit
- Trajnimi i organizatave partnere për hartim të politikave dhe avokim
- Hartimi i politikave për pjesëmarrje dhe vazhdim në arsim
- Trajnimi i 500 anëtarëve të SBASHK dhe KAHCR në nivel lokal për të drejtat e fëmijëve, drejtësinë shoqërore dhe avokim
- Organizimi i aktiviteteve për ngritje të vetëdijes

Të arriturat kryesore të Projektit janë prezantuar të grupuara sipas rezultateve:

- Ngritja e kapacitetit të organizatave partnere në projekt

  Një grup aktivitetesh janë realizuar gjatë vitit 2007 dhe kanë pasur të bëjnë me ngritjen e kapacitetit të organizatave partnere në këtë projekt. Për arritjen e këtij qëllimi janë mbajtur disa trajnime dhe vizita studimore që janë përshkruar në hollësi në raportin e vitit 2007.

  Në vitin 2008, për vitin 2008, përqendrimi ka qenë në zhvillimin e strategjisë se bashkëpunimit të rrjetit të përbërë nga KEC, SBASHK dhe KAHCR. Strategjia është zhvilluar me pjesëmarrje aktive të të gjithë partnerëve në formë të një serie të punëtorive dhe sesioneve konsultative.

- Mobilizimi i palëve kryesore me interes në fushën e pjesëmarrjes së fëmijëve në arsim

  Në mënyrë që të ndikohet për ngritjen e pjesëmarrjes në arsim nga të gjitha anët dhe në të gjitha nivelet është bërë përpjekje për mobilizimin e të gjitha palëve me interes në këtë fushë. Është krijuar grupi punues nga përfaqësues të KEC, SBASHK, KAHCR, MAShT, MPMS dhe AKK. Ky Grup Punues mori pjesë në vizitat studimore në Slloveni dhe Kroaci që u realizuan në vitin 2007. Ndërkaq, në vitin 2008 Grupi u mor me zhvillimin e dy politikave:

  1. *Përfshirja e fëmijëve në edukimin parashkollor,*
  2. *Pengimi i braktisjes në arsimin fillor.*

  Këto dy politika u prezantuan publikisht më 11 qershor 2008 dhe nxitën një interesim mjaft të madh të opinionit profesional dhe atij publik.

- Ndërtimi i kapacitetit të SBASHK dhe KAHCR për të ndikuar në përmirësimin e pjesëmarrjes në arsim

  Një nga aktivitetet e projektit është edhe trajnimi i 500 mësimdhënësve të Kosovës. Trajnimi i këtyre mësimdhënësve u bë nga të tri organizatat partnere: KEC – që mbajti trajnimin Edukimi për Drejtësinë Shoqërore; KAHCR – që mbajti trajnimin Edukimi për të Drejtat e Fëmijëve; dhe SBASHK – që mbajti trajnimin për Avokimin. Trajnimet u realizuan në periudhën dhjetor 2007-maj 2008 dhe 45% të pjesëmarrësve ishin femra. Për qëllime të trajnimit u publikuan dy doracakë nga KEC dhe KAHCR.

Në maj dhe në qershor të vitit 2008 u organizuan evenimente njëditore në shtatë qendrat regjionale të Kosovës (Prishtinë, Ferizaj, Gjilan, Gjakovë, Pejë, Mitrovicë dhe Prizren) me qëllim të sensibilizimit të opinionit për rritjen e pjesëmarrjes në arsim. Evenimentet kishin karaktere të ndryshme dhe u planifikuan nga ekipe lokale të aktivistëve të SBASHK dhe KAHCR.

Projekti përfundoi me konferencën ndërkombëtare njëditore që u mbajt më 8 korrik 2008 në Prishtinë. Konferenca mblodhi rreth 100 pjesëmarrës nga Kosova dhe vendet e Regjionit dhe në të u debatua për problemin e pjesëmarrjes në arsim dhe modalitetet për adresimin e tij.

5. KRIJIMI I MJEDISEVE TË SIGURTA, JO TË DHUNSHME DHE HUMANE NË SHOQËRI DHE SHKOLLA

Hyrje. – Projekti është disenjuar në vitin fund vitit 2007, ndërsa UNICEF ka vendosur që të ta financoj në shtator të vitit 2008. Zbatimi i tij ka filluar me 9 shtator të vitit 2008. Nga emërtimi i projekti shihet qartë se kemi të bëjmë me një proces shumë të ndërlikuar dhe kompleks. Ndihmë të madhe na kanë dhënë përfaqësuesit e UNICEF-it, të cilit në të gjitha ngjarjet e rëndësishme që lidhen me këtë projekt kanë marrë pjesë duke dhënë ide të dobishme dhe me interes.

Në punëtorinë e mbajtur në mars të vitit 2009, projekti fiton një përmasë të re dhe komplekse sepse pas prezantimit të bërë nga koordinatori i projektit për synimet, qëllimet dhe objektivat e tij, doli propozimi se arritja e këtyre piketave është tepër komplekse dhe me shumë rreziqe për shkak të gjerësisë së shtrirjes dhe të afatit të shkurtë. Përfaqësuesit e UNICEF propozuan që ky projekt të pilotohet në 5 komuna të Kosovës.

Pas punëtorisë së mbajtur, janë bërë ndryshime substanciale në zbatimin e Projektit sepse përveç që janë realizuar të gjitha objektivat dhe aktivitetet e parapara me projektin inicial, janë bërë evoluime të mëdha projektuese kështu që tani ky projekti përveç që përfshin pesë komuna pilot, ka fituar një përmasë kërkimore me të cilën synohet që arritjet dhe ndryshimet pozitive të bëra në 169 shkolla, jo vetëm që do të jenë të vëzhgueshme dhe të matshme, por që do te kenë edhe një argumentim shkencor.

Vëllimi i aktivitete është shtuar me elemente të reja të cilat mëtojnë që të fuqizojnë qëndrueshmërinë dhe kohëzgjatjen e projektit. Me adendum të veçantë ky projekt është zgjatur deri më 31 dhjetor 2009 (është dashur të përfundoj me 9 shator 2009). Në marrëveshje me UNICEF, disa aktivitete të këtij projekti do të vazhdojnë deri me 1 mars 2010 .

Objektivat dhe aktivitetet e Projektit.– *Projekti ka pas për qëllim të kontribuoj në ndërtimin mekanizmave funksionalë që do të mundësojnë krijimin e mjediseve të sigurta, jo të dhunshme dhe humane / miqësore në shoqëri dhe në shkolla me njeriun /fëmijën në qendër.*

Objektivat e këtij projekti janë:

1. Rritja e vetëdijes për rolin dhe rëndësinë që kanë mjediset e sigurta, jo të dhunshme dhe humane / miqësore për edukimin dhe zhvillimin njeriut dhe të fëmijës në shoqërinë kosovare
2. Krijimi i një rrejti të Fuqishëm Mbrojtës (në shkolla: Rrjeti i Brendshëm Mbrojtës, në shoqëri Rrjeti i Jashtëm Mbrojtës) me të cilin do të prevenohet – parandalohet ndikimi i faktorëve parazitarë të cilit mund të atakojnë sigurinë në shoqëri dhe në shkolla, të rrisin dhunën dhe të çrregullojnë raportet humane në shoqëri dhe në shkolla
3. Krijimi i një Plani Nacional me të cilin do të funksionalizohet veprim produktiv i Rrjetit të Fuqishëm Mbrojtës të Mjediseve të Sigurta, Jo të dhunshme dhe Humane/Miqësore në shoqëri dhe në shkolla

Aktivitetet:

Të arriturat kryesore të Projektit.– Projekti ka bërë që të rritet vetëdija për rolin dhe rëndësinë që ka krijimi i mjediseve të sigurta , jo të dhunshme dhe humane në shoqëri dhe në shkolla për:

- Zhvillimin maksimal fizik, mental, emocional dhe social të fëmijëve në edukimin parashkollor, fillor , të ulët të mesëm dhe të lartë të mesëm
- Rritjen e efikasitetit dhe të efektivitetet të institucioneve arsimore në Kosovë dhe transformimin e institucioneve arsimore në organizata të fuqishme të nxënit dhe prodhimit të dijeve të reja
- Parandalimin e të gjitha llojeve të dhunës në shoqëri dhe në shkollë
- Rritjen e partneritetit të shkollës me segmentet relevante të shoqërisë , me qëllim të krijimit të një mjedis koheziv dhe miqësor me njeriun fëmijën në qendër

Arritje të veçantë e këtij projekti janë:

- Mjediset e rregulluara dhe të estetizuara në një numër shumë të madh të shkollave me çka janë krijuar kushte për një mjedis më të përshtatshëm për të nxënit e suksesshëm

- Rritja e sigurisë në shkolla duke bërë rrethojat e shkollave (gjatë kësaj periudhe janë rrethuar mbi 20 shkolla); duke vendosur kujdestaritë e nxënësve në hyrje të objekte shkollore dhe neper kate si ndihmës të mësimdhënësve kujdestarë; duke i vendosur kartelat identifikuese për nxënës, duke i caktuar nxënësit vullnetarë për të garantuar siguri për nxënësit në shkollë, në oborrin shkollor dhe në relacionin shtëpi - shkollë dhe shkollë- shtëpi; duke vendosur kabina në hyrje të oborreve shkollore etj.
- Krijimi i Rrjetit të Fuqishëm mbrojtës të jashtëm në të cilin janë përfshirë rreth 40 veta nga shërbimet e ndryshme relevante të shoqërisë: Drejtoritë Komunale të Arsimit, Shërbimet e Inspektimit në Arsim, Policia Lokale, Shërbimi Sprovues, Shoqatat e Prindërve, Prindër, Shërbimet shëndetësore, Komitetet shkollore për mbrojtjen e të Drejtave të fëmijës- nxënës
- Krijimi i rrjetit të Fuqishëm Mbrojtës të Brendshëm të cilin e përbëjnë 168 Komitete Shkollore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës në të cilat janë përfshirë mbi 2 200 nxënës
- Krijimi i 169 Këshillave Koordinues për zbatimin projektit në të cilat janë përfshirë 845 persona (169 kryetarë të Këshillave të Shkollës, 169 drejtorë; 338 prind, 169 këshilltarë për të drejtat e fëmijës; 169 nxënës anëtarë të Komiteteve shkollore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës
- Janë vendosur 168 Kutia për të Drejtat e Fëmijës
- Në 169 shkolla është miratuar Rregullorja për përdorimin Kutisë për Mbrojtjen e të Drejtave të fëmijës
- Janë mbjellë mbi 2000 pisha dhe pemë të tjera në oborret shkollore
- Janë formuar mbi 100 Grupe të punës për zhvillime strategjike në të cilat do te integrohet filozofia e projektit
- Është rritur shkalla e pjesëmarrjes së nxënësve në vendimmarrje

Aktivitetet në vijim:

- Është duke u bere plani për monitorimin dytë
- Shkollat pilot janë duke hartuar PZHSH.
- Janë duke u bërë përgatitjet për vlerësimin e projektit përmes një hulumtimi të shpejtë
- Janë duke i bërë përgatitjet për organizimin e ekspozitave dhe të Konferencave për shtyp në komunat Pilot
- Është duke u bërë përgatitja për organizimin e një ekspozite dhe të një konference për shtyp në nivel nacional
- Është duke u hartuar një Protokoll Special për parandalimin dhunës i cili pas debatit publik në Rrjetin Mbrojtës të Krijuar do t'i propozohet MAShT për miratim
- Është në përgatitje e sipër Projekt – propozimi për vazhdimin e Projekti edhe në pesë komuna të tjera PILOT,nëse pas vlerësimit konstatohet se Krijimi i Rrjetit të Fuqishëm Mbrojtës ka prodhuar ndryshime sinjifikante-statistikisht të rëndësishme.

Sugjerimet për përmirësim në të ardhmen.- Me qëllim që të sigurohet qëndrueshmëria e projektit të gjitha shkollat pilot, janë duke hartuar planet zhvillimore për periudhën 2009//2010 – 2010/2014. Po ashtu, në përgatitje e sipër është Protokolli Special për parandalimin e dhunës, krijimin shkollave të sigurta dhe pa dhune dhe të mjediseve stimulative e miqësore për fëmije (një lloj PLANI NACIONAL). Për të rritur performancën e komiteteve komunale për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës dhe të Komitetit Rajonal për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës do të hartohet një udhëzim dhe do të kërkohen strategji për përkrahjen e punë së tyre

6. KOSOVISION CONTEST

Hyrje. – KOSOVISION CONTEST është një projekt arsimor në formë të një gare kombëtare që përcillet nga media i cili filloi në shtator të vitit 2008 dhe zgjat deri në maj të vitit 2011. Koncepti u zhvillua nga Universiteti i Edukimit në Cyrih të Zvicrës, ndërsa për herë të parë u realizua në vitin 2007 në Regjionin e Prizrenit, në bashkëpunim me KFOR-in. Pjesëmarrës në këtë projekt janë të gjitha klasat e pesta në Kosovë së bashku me mësimdhënësit e tyre të cilët merren me të tashmen dhe të ardhmen e Kosovës.

Ky projekt realizohet në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Qendrën për Arsim e Kosovës dhe Radio Televizionin e Kosovës.

Projekti financohet nga:

- DEZA, Drejtorati për zhvillim dhe bashkëpunim;
- Fondet e lotarive të Kantonit të Cyrihut;
- Fondacione private;
- Persona privat dhe ndërmarrje nga diaspora;
- Universiteti i Edukimit, Cyrih

Objektivat dhe aktivitetet e Projektit.– Ky projekt u mundëson fëmijëve që duke marr pjesë në këtë projekt të kontribuojnë për të ardhmen e vendit të tyre. Ata inkurajohen që ti shprehin vizionet e tyre dhe të bëhen aktiv.

Për nga përmbajtja, fëmijët janë marrë me tema nga mjedisi i tyre jetësor. Ato janë: arsimimi, infrastruktura dhe mjedisi, ekonomia dhe bashkëjetesa në Kosovë.

Projekti u dedikohet në radhë të parë të gjithë fëmijëve të klasave të pesta, pra mosha 11 dhe 12 vjeç nga të gjitha grupet etnike (shqiptarë, boshnjakë, goranë, romë, serbë dhe turq). Me anë të këtij projekti, preken edhe grupet tjera si: mësimdhënësit e klasave të pesta, udhëheqësit e shkollave, prindër dhe pjesa tjetër e popullatës.

Aktivitetet e projektit janë:

1. ***Punëtoritë*** – Personeli mësimor zhvilloi punëtori bashkë me nxënësit lidhur me të tashmen dhe të ardhmen e Kosovës.

2. ***Vlerësimi Rajonal dhe shpallja e fituesve*** – Në shtatë Rajonet e Kosovës (Prishtinë, Pejë, Gjakovë, Prizren, Mitrovicë, Gjilan e Ferizaj) janë vlerësuar

punimet e nxënësve. Pas vlerësimit të punimeve është bërë edhe shpallja e fituesve në secilin Rajon të Kosovës.

3. ***Shpërblimi i punimeve*** – 135 punimet më të mira nga të gjitha Rajonet e Kosovës janë shpërblyer (50 në vitin 2008 dhe 85 në vitin 2009). E gjithë kjo ceremoni është përcjell edhe nga Media.

4. ***Ekspozita*** – Në Prishtinë është bërë edhe ekspozita e rreth 1,200 punimeve nga të gjitha klasat pjesëmarrëse në projekt. Ekspozita ishte në dispozicion për të interesuarit për pesë ditë radhazi.

5. **Realizimi i projekteve -** në këtë fazë bëhet realizimi i ideve të cilat kanë dal nga punëtoritë e fëmijëve. Në këtë fazë do të punohet vetëm me klasat fituese të këtij projekti. Këto projekte udhëzohen dhe përkrahen nga mësimdhënësit. Organizohet takime me mësimdhënës ku ata do të bëjnë përshkrimin për secilin projekt dhe nga një plan projekti.

6. **Ndarja e shpërblimeve për projektet** – pas realizimit të projektit, vjen një fazë tjetër ku edhe bëhet vlerësimi i tyre. Edhe kjo fazë mbikëqyret dhe vlerësohet nga ekipe vlerësuese në të gjitha Rajonet e Kosovës. Pas vlerësimeve do të zgjidhen disa projekte më të mira të cilat do të shpërblehen sërish për punën e bërë. I gjithë ky aktivitet përcillet nga media.

7. **Nderimi** – Pasi të kenë përfunduar të gjitha aktivitetet e parapara me projekt, vizitohen klasat fituese nga një delegacion i cili bën nderimin e këtyre klasave për punën e bërë.

Të arriturat kryesore të Projektit.– Cikli i parë i projektit u zhvillua në periudhën shtator 2008-maj 2009 dhe gjatë tij u realizuar të gjitha aktivitetet e përshkruara më sipër. Ndërkaq, në gusht të vitit 2009 filloi cikli i dytë i projektit, i cili karakterizohet me këto të arritura:

Punëtoritë – Personeli mësimor ka zhvilluar punëtori bashkë me nxënësit lidhur me të tashmen dhe të ardhmen e Kosovës, në bazë të temave të dhëna në projekt. Punëtoritë kanë zgjatur nëntë javë ku nxënësit kanë dizajnuar postera (pllakate) së bashku me idetë dhe paramendimet e tyre lidhur me të ardhmen. Ata kanë përshkruar në formë të projektit ideor kontributin, të cilën klasa do të mund ta jepte për realizimin e këtij projekti. Gjithsej pjesëmarrës në këtë projekt ishin rreth 1200 klasa të pesta nga mbarë Kosova.

Vlerësimi Rajonal dhe shpallja e fituesve – Në shtatë Rajonet e Kosovës (Prishtinë, Pejë, Gjakovë, Prizren, Mitrovicë, Gjilan e Ferizaj) janë vlerësuar punimet e nxënësve në bazë të kritereve të dhëna nga hartuesit e projektit. Vlerësimet janë bërë nga grupe vlerësuese, ku secili Rajon ka pasur një grup me nga tre ose pesë persona për vlerësim. Këta vlerësues kanë qenë të profileve të ndryshme si: piktor, prindër, drejtues shkollash por edhe zyrtarë të Arsimit e mësimdhënës. Pas vlerësimit të punimeve është bërë edhe shpallja e fituesve në secilin Rajon të Kosovës. Janë zgjedhur 85 klasa fituese të cilët vazhdojnë garën edhe në fazën e dytë të projektit.

Shpërblimi i punimeve – 85 punimet më të mira nga të gjitha Rajonet e Kosovës janë shpërblyer. Po ashtu, secila klasë pjesëmarrëse në projekt është pajisur me një certifikatë e cila dëshmon punën dhe kreativitetin e fëmijëve pjesëmarrës në garë. E gjithë kjo ceremoni është përcjell edhe nga Radio Televizioni i Kosovës ku po atë ditë është bërë edhe tërheqja për tre fitues të rastësishëm në nivel të Kosovës. Ata janë: Shkolla "Naim Frashëri", Prishtinë – klasa V4 me mësuesen Remzije Baraku, Shkolla "Ruzhdi Xhyliqi", Marali-Malishevë – klasa V me mësues Skender Paqarizi, Shkolla "Trepça", Banjë e Pejës – klasa V1 me mësuesen Mehrije Buleshkaj-Haxhijaj. Fituesit e rastësishëm do të kenë fatin që nxënësit e tyre ti shpërblejnë me një pushim të shkurtër dimëror.

Ekspozita – Në Prishtinë është organizuar ekspozita e punimeve e të gjitha klasave pjesëmarrëse në projekt. Ekspozita ishte në dispozicion për të interesuarit për pesë ditë radhazi. Pjesëmarrja e madhe e vizitorëve, respektivisht fëmijëve në ekspozitë ka zgjuar kureshtje edhe më të madhe për nxënësit që edhe më tutje të vazhdojnë me projekte të tilla siç është KOSOVISION CONTEST.

Në këtë projekt janë angazhuar një numër i konsiderueshëm i njerëzve (12 persona) të cilët ndihmojnë në realizimin e projektit. Varësisht nga numri i klasave të pesta nëpër komuna, është bërë edhe zgjedhja e personave (një ose dy persona në Rajon) të cilët punojnë në projekt dhe të cilët kanë dhënë kontribut të jashtëzakonshëm për mbarëvajtje sa më të mirë të punës.

Sugjerime për përmirësim në të ardhmen.– Qëndrueshmëria synohet të arrihet në nivele të ndryshme. Fëmijët dhe mësimdhënësit inkurajohen të shërbehen nga kompetencat dhe burimet e tyre dhe kjo bën që ata të bëhen më aktiv, pra planifikojnë dhe realizojnë.

Qëllimi është që pas tri vitesh, elementet qendrore të projektit të hyjnë në planin e rregullt mësimor dhe t'u mundësohet mësimdhënësve dhe shkollave që të zhvillojnë edhe vet projekte të tilla, të cilat do të financoheshin nga fonde të ndryshme.

Pasi që i tërë projekti përcillet nga Radio Televizioni i Kosovës, mundësia për qëndrueshmëri të projektit është më e madhe. Transmetuesi publik transmeton rregullisht material – emisione për punën të cilën e bëjnë nxënësit dhe do të vazhdoj me emetimin e emisioneve edhe më tutje. Kjo bën që nxënësit të jenë më kureshtar dhe zgjon interesim të jashtëzakonshëm te ata.

7. PROMOVIMI I TË DREJTAVE TË FËMIJËS NË FUSHËN E ARSIMIT

Hyrje. – Qendra për Arsim e Kosovës zbaton projektin "Promovimi i të drejtave të fëmijës në fushën e arsimit" që nga janari i vitit 2009. Financues i këtij projekti është: Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian në Kosovë (ECLO) - Instrumenti për Demokraci dhe të Drejtat e Njeriut (EIDHR). Projekti bashkë financohet nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur (KFOS) ndërsa partner në implementim është Shoqata Kosovare për të Drejtat e Njeriut dhe Fëmijës (KAHCR). Projekti zbatohet në Rajonin e Prishtinës, dhe Prizrenit, respektivisht në komunat Prishtinë, Fushë Kosovë, Prizren dhe Dragash, dhe do të zgjas 30 muaj.

Objektivat dhe aktivitetet e Projektit.– *Objektiva e përgjithshme e projektit është* të *kontribuohet në zhvillimin e demokracisë në Kosovë duke mobilizuar shoqërinë civile dhe palët tjera të interesit që të nxisin respektimin e të drejtave të fëmijës në fushën e arsimit.*

Objektiva specifike e projektit është *të rritet vetëdija për situatën e të drejtave të fëmijës në fushën e arsimit në Kosovë, duke organizuar veprim të bashkërenduar monitorimi të shoqërisë civile në kooperim me autoritetet qendrore dhe lokale, si dhe duke krijuar kapacitetin e shkollave që të kontribuojnë në këtë përpjekje.*

Rezultatet e pritura të këtij projekti janë: 1) Zhvillimi i një sistemi të monitorimit dhe 2) Raportimi i situatës së të drejtave të fëmijës në fushën e arsimit dhe përgatitja e pakove të trajnimit për të drejtat e fëmijës dhe evokimin për nxënës.

Për ti arritur këto rezultate bëhen aktivitete të ndryshme. Për rezultatin e parë janë paraparë këto aktivitete:

- Zgjedhja e shkollave të synuara për monitorim dhe shkollat e grupit kontroll;
- Përpunimi i një kornize të monitorimit;
- Aftësimi i monitorëve
- Monitorimi i situatës së të drejtave të fëmijës në fushën e arsimit;
- Përgatitja dhe prezantimi i raporteve të monitorimit.

Ndërsa për rezultatin e dytë janë paraparë këto aktivitete:

- Formimi/mobilizimi i komiteteve për të drejtat e fëmijës në shkollat e synuara;
- Organizimi i trajnimit për nxënës dhe mësues;
- Organizimi i aktiviteteve vetëdijesimi;

Të arriturat kryesore të Projektit

Zgjedhja e shkollave të synuara për monitorim dhe shkollat e grupit kontroll.– Gjithsej janë zgjedhur 30 shkolla të grupit të synuar dhe 30 shkolla të grupit kontroll nga 4 komunat. Përzgjedhja e shkollave është bërë në bashkëpunim me Drejtoritë komunale të komunave përfituese në projekt duke u bazuar në kriteret e dhëna në projekt. Gjatë procesit të zgjedhjes së shkollave, jemi fokusuar në shkollat të cilat kanë të funksionalizuara komitetet shkollore ose te shkollat ku këto komitete kanë funksionuar më herët por që tani nuk funksionojnë. Vëmendje e kushtuar u është dhënë edhe shkollave të cilët kanë nxënës të minoriteteve dhe atyre me nxënës me

nevoja të veçanta. Në secilën prej këtyre shkollave janë zgjedhur nga dy mësimdhënës të cilët do të punojnë aktivisht me komitetet shkollore, pra monitorë të brendshëm të shkollave. E gjithë kjo punë do të ndihmohet edhe nga monitorët e jashtëm e që gjithsej janë 6. Tre prej tyre do të veprojnë në komunat Prishtinë dhe Fushë Kosovë dhe tre prej tyre në komunat Prizren dhe Sharr.

Zhvillimi i kornizës gjithëpërfshirëse për monitorimin e të drejtave të fëmijës në arsim.–
Qendra për Arsim e Kosovës ka angazhuar dy ekspertë të arsimit të cilët fillimisht kanë bërë hulumtime për të drejtat e fëmijës dhe mënyrës së bërjes së kornizës së monitorimit. Pas analizave të bëra është ftuar një grup pjesëmarrësish në një punëtori dy ditore të cilët kanë ndihmuar në zhvillimin e kësaj kornize të monitorimit. Pas mbledhjes së të dhënave dhe ideve të marra nga grupi, ekspertët kanë përpiluar kornizën gjithëpërfshirëse të monitorimit e cila tani shërben për punën e mëtutjeshme në projekt. Kjo kornizë monitorimi është përkthyer edhe në gjuhën boshnjake, turke dhe angleze.

Aftësimi i monitoruesve dhe organizimi i monitorimit.– Në bazë të kornizës për monitorim është bërë edhe aftësimi i monitoruesve të brendshëm dhe atyre të jashtëm për mënyrën e monitorimit në shkolla. Ky aftësim ka zgjatur dy ditë për secilën komunë. Duke u bazuar në metodologjinë e monitorimit situata e të drejtave të fëmijës në fushën e arsimit do të monitorohet në shkollat e synuara dhe ato të grupit të kontrollit. Ky monitorim do të bëhet katër herë. Këtë vit është bërë monitorimi i parë dhe i dyti do të bëhet në muajin mars të vitit 2010 kur edhe publikohet, prezantohet dhe diskutohet raporti për mbarëvajtjen e monitorimit.

Aktivitetet tjera vazhdojnë në vitin e dytë të projektit.

Sugjerime për përmirësim në të ardhmen.– Projekti "Promovimi i të drejtave të fëmijës në fushën e arsimit" ka filluar të zbatohet në janar të vitit 2009 dhe do të zgjas deri në qershor të vitit 2011. Qëndrueshmëria e këtij projekti lidhet me rezultatet e konstatuara me rastin e hulumtimit. Konkretisht, nëse në monitorim dhe vlerësim në grupin eksperimental përcaktohen dallime statistikisht të rëndësishme në raport me grupin kontrollues, atëherë ky projekt do të hap rrugën për vazhdimin e aktiviteteve me komitete të të drejtave të fëmijës dhe do ta lehtësonte sigurimin e fondeve për këto qëllime.

8. AVANCIMI I PJESËMARRJES DHE PËRFAQËSIMIT TË GRUPEVE TË PAKICAVE ETNIKE NË ARSIM

Hyrje. – Projekti "Avancimi i Pjesëmarrjes dhe Përfaqësimi të Grupeve të Pakicave Etnike në Arsim" (APREME) ka filluar të zbatohet në maj të vitit 1999. Ky projekt financohet nga Komisioni Evropian me seli në Bruksel dhe Instituti për Shoqëri të Hapur me seli në Budapest. APREME është projekt rajonal ku marrin pjesë 6 shtete të Ballkanit Perëndimor. KEC nga Kosova është implementues i këtij projekti, ndërsa partnerë në zbatimin e projektit janë: Fondacioni i Shoqërisë së Hapur, Shqipëri; proMente – Hulumtim Social, Bosnjë dhe Hercegovinë; Rrjeti i Qendrave për Politika Arsimore (NEPC), Kroaci; Grupi MOST, Serbi; dhe Qendra për Arsim 2000+, Rumani, në cilësinë e ekspertit nga BE.

Edhe pse projekti zyrtarisht ka filluar të zbatohet në maj 2009, organizatat partnere, me ndihmën e Institutit për Shoqëri të Hapur, janë takuar fillimisht në dhjetor 2008 në Bukuresht, Rumani. Gjatë takimit dy ditor u diskutuan në detaje të katër komponentat e projektit, aspekti financiar dhe përgjegjësitë e partnerëve në kuadër të projektit.

Objektivat dhe aktivitetet e Projektit.– Projekti merret me avancimin e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të pakicave etnike në sistemet e arsimit në shtetet e Ballkanit Perëndimor duke i promovuar praktikat e mira dhe duke i përkrahur iniciativat lokale. E gjithë kjo bëhet në kuadër të objektives së përgjithshme të projektit, e që është "të kontribuohet në ndërtimin e sistemeve arsimore gjithëpërfshirëse në shtetet e Ballkanit Perëndimor që promovojnë qasje të barabartë në arsimin cilësor për të gjithë dhe janë model për respekt ndaj diversitetit etnik".

Rezultatet e pritshme të projektit janë:

1. Rrjeti funksional rajonal për avancimin e gjithëpërfshirjes arsimore është ndërtuar
2. Informata relevante mbi pjesëmarrjen dhe përfaqësimin e grupeve të pakicave etnike në nivel shkolle në dispozicion
3. Praktikat e mira për sigurimin e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit janë mbledhur dhe shpërndarë
4. Iniciativat lokale për përmirësimin e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit janë inkurajuar

Të arriturat kryesore të Projektit.– Pas fillimit të projektit, secili partner emëroi koordinatorin e vet dhe atë si në vijim: KEC - Jehona Shala, menaxher i projektit, Nora Tafarshiku, menaxher financiar; OSFA – Mimoza Gjika; NEPC – Eli Pijaca; proMente – Esad Bratovic; MOST – Snjezana Mrse; CEDU 2000+ – Mihaela Truca.

Gjatë takimit të parë virtual të grupit drejtues të projektit u caktuan pjesëmarrësit në Konferencën "Konsolidimi i partneriteteve në mes të organizatave të shoqërisë civile dhe autoriteteve publike në ngritjen e të drejtave të pakicave në regjion", të organizuar nga Komisioni Evropian. U diskutua edhe plani i veprimit për gjashtë muajt në vijim, si dhe u mor vendim që dy ekspertëve nga Rumania tu bashkëngjitet edhe një ekspert me përvojë nga Britania e Madhe.

Konferenca "Konsolidimi i partneriteteve në mes të organizatave të shoqërisë civile dhe autoriteteve publike në ngritjen e të drejtave të pakicave në regjion" u mbajt më 6 dhe 7 korrik në Bruksel. Projekti APREME u përfaqësua me 4 pjesëmarrës nga shtetet partnere.

Është krijuar ueb faqja e projektit www.apreme.net ku mund të gjenden informatat bazë për projektin dhe e cila do të freskohet me informata të reja gjatë kohë-zgjatjes së projektit.

Më 1, 2 shtator është mbajtur takimi i hulumtuesve në kuadër të komponentës 2 të projektit "Hulumtimet kombëtare" kur morën pjesë nga një përfaqësues/hulumtues prej secilit shtet partner si dhe dy ekspertë nga Rumania e një nga Britania e Madhe. Gjatë takimit u diskutua në detaje komponenta 2 e projektit dhe u caktuan përgjegjësitë dhe afatet deri në përfundim të aktiviteteve për të. Deri më tash, është hartuar korniza për hulumtim dhe janë përfunduar hulumtimet në terren. Gjatë janarit do të mblidhen raportet nga shtetet partnere që do të shfrytëzohen për një sintezë të përbashkët të hulumtimeve.

"Praktikat më të mira" komponenta 3 e projektit – janë emëruar ekipet kombëtare të cilat do të merren me mbledhjen e praktikave më të mira sa i përket përfaqësimit dhe pjesëmarrjes së pakicave në shtetet përkatëse. Është hartuar edhe korniza për mbledhjen e praktikave që ka qenë ndihmesë e madhe për ekipet kombëtare. Në janar përfundon afati për mbledhjen e praktikave dhe secili shtet do t'i zgjedh 3 praktikat më të mira të cilat do të botohen në një libër.

9. PROJEKTI PËR PËRMIRËSIMIN E PJESËMARRJES NË ARSIM II

Hyrje. – Projekti për përmirësimin e pjesëmarrjes në arsim (PPPA) është një projekt që u financua nga Banka Botërore dhe u implementua në vitet 2003 – 2006 në tërë Kosovën. Këtij projekti i kishte paraprirë një pilot projekt i titulluar Projekti Pilot për Grante Shkollore i cili ishte implementuar në vitin 2002 – 2003 në rajonin e Prishtinë dhe të Gjakovës. Gjatë katër viteve të implementimit të këtij projekti më shumë se gjysma e shkollave fillore dhe të mesme të Kosovës përfituan grante të vogla shkollore me të cilat adresuan çështjet e zvogëlimit të braktisjes, rritjes së vijueshmërisë dhe shtimit të shkallës së regjistrimit të nxënësve në shkollë, me fokus të veçantë në fëmijët që vinin nga grupet jo të favorizuara.

Projekti për Përmirësimin e Pjesëmarrjes në Arsim II (PPPA II) është një vazhdim i projektit PPPA, me disa specifika që nuk i kishte ky i pari. Ky projekt filloi së implementuari në janar të vitit 2008 dhe përfundoi në janar 2009. Implementimi u bë në tri rajone: në rajonin e Prishitnës, Mitrovicës dhe Prizrenit.

Objektivat dhe aktivitetet e Projektit.– Objektivi i përgjithshëm dhe afatgjatë i Projektit për Përmirësimin e Pjesëmarrjes në Arsim (PPPA) II është që *të përkrahë qeverinë e re të Kosovës së pas-statusit në avancimin e gjithëpërfshirjes dhe tolerancës në arsim. Më konkretisht, PPPA II synon të identifikojë mjete efektive për ngritjen e cilësisë së mësimdhënies, të nxënit dhe të arsimimit gjithëpërfshirës që do të shërbente si bazë për të hartuar një projekt të ardhshëm të IDA-së në arsimin kosovar.*

Projekti i ka dy komponenta: komponentën e granteve komunale dhe komponentën e granteve shkollor. Komponenta e Granteve për Zhvillimin e Arsimit në Komuna (GZHK) *synon të forcojë kapacitetet institucionale të komunave në identifikimin e nevojave të shkollave përmes planifikimit të nisur nga shkolla dhe në organizimin e aktiviteteve arsimore në tërë komunën të cilat do të afirmonin përmirësimin e cilësisë, arsimimin gjithëpërfshirës dhe pjesëmarrjen e komunitetit.*

Ndërsa në kuadër të komponentës së dytë synohet *të eksperimentojë një qasje të re për Grantet për Zhvillimin e Shkollës (GZHSH), duke përqendruar vëmendjen në përmirësimin e cilësisë së aktiviteteve të mësimdhënies e të të nxënit, përfshirjen e nxënësve në gjendje të rëndë dhe të grupeve etnike minoritare*[1] *në arsim dhe forcimin e pjesëmarrjes së komunitetit në shkolla...*

Grantet komunale u ofruan për pesë komuna në tri rajonet ku projekti është operativ. Përfituese të këtyre granteve janë komunat: Fushë Kosova, Obiliqi, Prizreni, Vushtrria dhe së fundi Mitrovica.

Komponenta e granteve shkollore ishte planifikuar të menaxhohet përmes dy cikleve të granteve shkollore, por kjo komponentë është zgjeruar edhe me një cikël të ri të granteve, për shkak të mjeteve të pashfrytëzuara nga shkollat me mësim në gjuhën serbe, në dy ciklet paraprake. Rrjedhimisht edhe koha e implementimit të projektit është shtyre për tre muaj (deri në janar 2009).

Aktivitetet më të rëndësishme që u zhvilluan në kuadër të projektit janë:

- Trajnimi me përfaqësues të shkollave dhe Komitetin Komunal për Grantin Arsimor (KKGA) – Përfaqësuesit e shkollave janë trajnuar për hartimin e planeve zhvillimore të shkollës dhe për përgatitjen projekteve shkollore. Këto trajnime janë mbajtur në nivelin rajonal. Ndërsa përfaqësuesit e Komiteteve Komunale për Grantin Arsimor janë aftësuar për hartimin e planit zhvillimor të komunës në arsim dhe përgatitjen e projektit komunal të arsimit.
- Ndihma profesionale shkollave dhe komunave në hartimin e planeve zhvillimore dhe projekteve, si dhe në implementimin e këtyre projekteve – Bashkëpunëtorët profesionalë të terrenit (BPT) kanë ndihmuar këshillat e shkollave dhe KKGA në hartimin e dokumenteve strategjike dhe projekteve të tyre dhe më pas kanë ofruar konsultime në realizmin e këtyre projekteve.
- Pjesëmarrja në takimet e Ekipeve Komunale për Grante Shkollore (EKGSh) dhe në takimet e Këshillit për Aprovimin e Granteve Shkollore (KAGSh) – në këto takime është raportuar për planet zhvillimore dhe projektet e përgatitura nga shkollat dhe komunat, me qëllim që të lehtësohet procesi i vlerësimit dhe i aprovimit të projekteve shkollore dhe projekteve komunale.
- Monitorimi i projekteve shkollore – BPT kanë bërë vizita monitorimi nëpër shkolla dhe i kanë përmbledhur rezultatet e monitorimit në një kornizë raportimi. Procesi i monitorimit është ndërmarrë në muajin tetor 2008 dhe janar 2009 dhe ka përfshirë periudhat janar – shtator 2008 dhe tetor-dhjetor 2008, përkatësisht.

Të arriturat kryesore të Projektit.– Në kuadër të projektit kanë përfituar grante 124 shkolla në tri rajone, ndërsa kanë përfituar grante komunale 5 komuna.

[1] Përfshinë serbët, romët, goranët, boshnjakët, turqit, ashkalinjtë dhe egjiptasit.

Pasqyra e përfituesve nga projekti sipas rajoneve	
Projektet shkollore të aprovuara - Prishtina - Mitrovica - Prizreni	124 projekte shkollore 45 projekte shkollore 41 projekte shkollore 38 projekte shkollore
Projektet komunale të aprovuara - Prishtina - Mitrovica - Prizreni	5 projekte komunale 2 projekte komunale 2 projekte komunale 1 projekt komunal

Në trajnimet e organizuara me përfaqësues të shkollave dhe komunave në kuadër të projektit, kanë marrë pjesë mbi 250 pjesëmarrës dhe ky proces është kurorëzuar me 472 certifikata të pjesëmarrjes në tri programe trajnimi.

Aktivitetet e projektit janë zhvilluar sipas planit dinamik. Kjo është bërë e mundur në saje të koordinimit mes Ekipit Koordinues të Projektit (EKP), stafit të KEC dhe shkollave e komunave. Nga ky bashkëpunim ka pasur disa përjashtime, që vinin kryesisht nga neglizhenca e ndonjë shkolle apo komune, por këto janë evituar me një përpjekje shtesë të bashkëpunëtorëve profesionalë të terrenit apo stafit të EKP.

Gjatë periudhës implementuese nuk është arritur të finalizohet edhe rezultati i projektit që ka të bëj me ndikimin e intervenimit në përmirësimin e pjesëmarrjes në arsim. Me gjithë faktin se janë përzgjedhur 30 shkolla përfituese dhe 30 të tjera jopërfituese dhe janë marrë të dhënat prej tyre, nuk është parë e udhës që të bëhet çfarëdo interpretimi pa kaluar një periudhë kohore më e gjatë e përcjelljes. Kështu, KEC do të vazhdojë të mbledhë të dhëna prej këtyre shkollave në tri vitet e ardhshme për të dalë pastaj me një analizë të informuar.

10. EDUKIMI PËR TË DREJTËN SHOQËRORE

Hyrje. – Qendra për Arsim e Kosovës me ndihmën financiare nga KFOS, nga muaji janar 2007, filloi implementim e një projekti, qëllimi i të cilit ishte që të filloj të përhapet ideja e Drejtësisë Shoqërore në shoqërinë kosovare si dhe, trajnerët e ri të fillojnë zbatimin e njohurive të fituara. Ky qëllim ishte menduar të arrihet përmes trajnimeve nga programi EDSH që do të organizoheshin nëpër Kosovë.

Programi EDSH, deri më tash është duke u implementuar me ndihmën e donatorëve të ndryshëm. Kështu, në muajin tetor të vitit 2009, Ambasada Amerikane në Prishtinë, vendosi që ta përkrahë këtë projekt për 3 muaj.

Objektivat dhe aktivitetet e Programit.– Programi "Edukimi për të drejtën shoqërore" është një program trajnimi që ka për qëllim krijimin e vetëdijes kritike për të njohur diversitetin kulturor, gjuhësor dhe etnik si vlerë njerëzore. Pranimi i të tjerëve pa paragjykime, të qenit tolerant dhe i hapur, janë sjellje thelbësore të çdo

qytetari, si dhe kusht për krijimin e një shoqërie demokratike. Një qasje e tillë i mundëson çdo qytetari të drejtën për të qenë i pranuar dhe i trajtuar në mënyrë të drejtë dhe të barabartë në aspektin individual, shoqëror dhe institucional.

Aktivitetet e projektit që janë zhvilluar gjatë vitit 2009 kanë qenë:

- Vizita e ekspertit ndërkombëtar dhe zhvillimi i trajnimit për trajner, për të ngritur kapacitetet e trajnerëve vendor
- Organizimi i trajnimit 4 ditor në Prishtinë, ku trajnerët lokal nën fasilitimin e ekspertit ndërkombëtar zhvilluan trajnimin EDSH të plotësuar me idetë dhe njohuritë për zgjidhjen e padhunshme të konflikteve.

Të arriturat kryesore të Programit. – Organizimi i këtyre tre trajnimeve, dhe certifikimi i tyre konsiderohet si një hap më shumë drejt ngritjes së kapaciteteve njerëzore për promovimin e drejtësisë shoqërore. Gjithashtu, trajnimi dhe takimet e shumta me ekspertin ndërkombëtar kanë bërë të mundur ngritjen e kapaciteteve të trajnerëve vendor, dhe pasurimin e tyre me ide dhe njohuri të reja për Drejtësinë shoqërore dhe zgjidhjen e konflikteve.

Sugjerimet për përmirësim në të ardhmen.– Observimi kryesor ka të bëj me qëndrueshmërinë e këtij projekti, që lidhet me mundësinë që ky program trajnimi të mund të implementohet si program kros-programor, çka do të thotë se mund të gjenden lidhjet me çdo program tjetër trajnimi, si dhe mund të përfshihet në programet ekzistuese të trajnimit.

11. QENDRA PËR PËRSOSMËRI NË MËSIMDHËNIE

Hyrje. – Ky projekt është hartuar për t'u implementuar në bashkëpunim me partnerët nga Universiteti i Nyrnbergut (Gjermani) dhe ai i Lincit (Austri), me qëllim të funksionalizimit të Qendrës për Përsosmëri në Mësimdhënie (QPM) të Universitetit të Prishtinës. QPM-ja ishte themeluar një vit më parë me qëllim të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies në Universitetin e Prishtinës, por, për arsye të ndryshme, pos pajisjes së zyrës kryesore dhe zbatimit të një apo dy programeve trajnuese, nuk kishte arritur të organizojë ndonjë program apo aktivitet relevant që do të kishte ndikim në cilësinë e mësimdhënies në UP. Kështu, para fillimit të projektit, QPM-ja nuk kishte personel të vetin të përhershëm, nuk kishte dokumente dhe rregullore të brendshme të punës, nuk i kishte organet kryesore, mungonin programet e trajnimit, e të tjera.

Në këtë kontekst, udhëheqja e Universitetit të Prishtinës kishte kërkuar nga KEC të hartojë një projekt për funksionalizimin e QPM-së. Për këtë qëllim ishte hartuar një projekt TEMPUS dhe ishin identifikuar e kontraktuar partnerët implementues (QPM-ja e Universitetit të Nyrnbergut në Erlangen) dhe kishte filluar implementimi me KEC-in si partner kontraktues.

Objektivat dhe aktivitetet e Projektit.– Siç u tha më lartë, qëllimi kryesor i projektit ishte funksionalizimi i QPM-së të Universitetit të Prishtinës, ndërkaq objektivat kryesorë të projektit janë:

a) Aftësimi i trajnerëve

b) Zhvillimi i kurseve dhe programeve të trajnimit, dhe

c) Funksionalizimi i udhëheqjes së qendrës.

Projekti u realizua prej qershorit 2007 deri më maj 2008 përmes këtyre aktiviteteve kryesore:

1. Organizimi i programeve trajnuese për trajnerët e qendrës (përmes seminareve, punëtorive, udhëtimeve studimore, mentorimit, etj);
2. Hartimi i dokumentacionit, procedurave dhe programeve trajnuese të qendrës;
3. Ndihmë në aftësimin dhe ngritjen e kapaciteteve menaxhuese të personelit të qendrës (përmes udhëtimeve studimore, aftësimit pa shkëputje nga puna, punëtorive, etj).
4. Furnizimi i bibliotekës së Qendrës me literaturë relevante;
5. Zhvillimi i dy programeve trajnuese për 60 mësimdhënës të Universitetit të Prishtinës, etj.

Të arriturat kryesore të Projektit. – Aktivitetet e projektit janë realizuar sipas planifikimit dhe, në një masë të madhe, kanë tejkaluar planifikimin.

a) Blerja e një numri të librave;

b) Emërimi i një administratori të qendrës me marrëdhënie të përhershme pune; emërimi i Bordit udhëheqës të QPM-së; dhe një pjesë e aftësimit pa shkëputje nga puna të administratorit, si dhe aftësimi përmes udhëtimit studimor të anëtarëve të Bordit të Qendrës;

c) Organizimi i punëtorisë së parë (1-6 tetor 2007 në Prishtinë, në lokalet e KEC-it) për përzgjedhjen dhe aftësimin e 15 trajnerëve të QPM-së nga trajnerët e institucionit partner;

d) Organizimi i udhëtimit studimor një javor në institucione simotra në Gjermani (Nyrnberg, Regensburg, Ingolstadt, Heidelberg, Stuttgardt, dhe Dortmund), si dhe, në kuadër të tij, trajnimi dy ditor në lëmin e hartimit të programeve e të kurseve trajnuese për mësimdhënie në institucionet e arsimit të lartë. Ky aktivitet ka qenë nismëtar për ndërtimin e kapacitetit të trajnerëve. Pas një punëtorie tjetër që është mbajtur më 20-24 janar 2008 në Mitrovicë është arritur të zhvillohen 6 programe trajnimi (nga dy sa ka qenë e planifikuar) dhe të përgatiten 16 trajnerë për implementimin e tyre (nga 10 sa ka qenë e planifikuar).

e) Vizita e dytë për Bordin e Qendrës është realizuar në periudhën 20-25 prill 2008 në Fakultetin e Edukimit në Linz.

f) Është ofruar ndihmë e vazhdueshme për koordinatorin e Qendrës, si nga kontraktori gjerman, ashtu edhe nga partneri vendor. Në këtë kontekst është organizuar një qëndrim njëjavor për koordinatorin në Universitetin e

Nyrnbergut, si dhe i është ndihmuar ta hartojë planin e punës për vitin shkollor 2008/09.

g) Në vend të tri trajnimeve për 60 mësimdhënës të UP, janë organizuar 5 dhe në to janë përfshirë 90 mësimdhënës të UP. Trajnimet kanë zgjuar shumë interesim, ndërsa në to kanë qenë të pranishëm mësimdhënës me thirrje të ndryshme universitare.

h) Ueb-faqja e projektit është pjesë e ueb faqes së UP.

Vështirësitë kishin të bënin kryesisht me koordinimin e përpjekjeve ndërmjet partnerëve dhe kryerjen e obligimeve nga ana e UP-së, përfshirë angazhimin e personelit të QPM-së. Për fat të keq, me të përfunduar të Projektit, aktiviteti i QPM nuk vazhdoi më tutje, me gjithë faktin se UP u zotua se do ta përkrahë këtë njësi organizative.

12. Access Microscholarship Program

Hyrje. – Programi ACCESS, ka filluar në shtator të vitit 2006. Ky program financohet nga Ambasada e SHBA në Kosovë, ndërsa zbatohet nga KEC. Në vitin 2007/08 në këtë program janë përfshirë rreth 60 nxënës të shkollave të mesme nga tri komuna të Kosovës: Prishtinë, Prizren dhe F. Kosovë, të cilët për dy vjet kanë qenë përfitues të Programit. Nxënësit janë të komuniteteve të ndryshme etnike që jetojnë në Kosovë: shqiptarë, serbë, turq, boshnjakë. Ndërkaq, në vitin shkollor 2008/09 Programi zhvillohet në Prizren me një grup të nxënësve dhe Prishtinë me dy grupe nxënësish, me gjithsej 52 nxënës.

Mësimi mbahet dy herë në javë, nga dy orë akademike. Mësimi organizohet me mësues ekspertë amerikanë. Secili grup do të vijojë 120 orë mësimi për një vit. Programi zgjatë dy vjet.

Objektivat dhe aktivitetet e Projektit.– Qëllimi i Programit në Kosovë është të rritet kuptimi i ndërsjellë mes njerëzve dhe të fuqizohen lidhjet të cilat i bashkojnë ata përmes demonstrimit e interesave edukative dhe kulturore, zhvillimeve, dhe arritjeve dhe me këtë të asistohet në zhvillimin e marrëdhënieve miqësore dhe paqësore. Aktivitetet janë të ndara në dy fusha: aktivitetet mësimore dhe aktivitetet sociale.

Të arriturat kryesore të Projektit - Aktivitetet mësimore.- Aktivitetet mësimore kanë të bëjnë më tepër me mësimdhënien, si pjesë shtesë në metodologjitë e mësimdhënies. Aktivitetet mësimore janë më tepër të natyrës hulumtuese, ku nxënësve u jepen detyra të hulumtojnë, mendojnë dhe diskutojnë për tema të ndryshme sociale, kultura, tradita, zakone të etnive dhe vendeve të ndryshme. Dy grupet e Prishtinës kanë filluar mësimin dhe aktivitetet e tyre në pjesën e dytë të shtatorit, ndërsa grupi i Prizrenit deri më tash nuk ka filluar mësimin pasi që mësimdhënësi nuk e ka vazhduar punën për këtë vit akademik. Ambasada Amerikane e cila është edhe financuesi i këtij projekti dhe përgjegjës për sigurimin e mësimdhënësit amerikan nuk ka arritur ta gjejë një mësimdhënës për grupin e Prizrenit.

Aktivitetet sociale.- Pasi nxënësit vijnë nga etni të ndryshme, aktivitetet sociale janë paramenduar të kryhen së bashku, me qëllim që të kuptojnë më mirë njëri-tjetrin, traditat, gjuhën dhe kulturën, si dhe të fuqizojnë miqësinë ndërmjet vete. Këto aktivitete janë të natyrës rekreative, pasi rekreacioni si element i përbashkët inkurajon fëmijët të rrinë më afër me njëri-tjetrin. Deri tash janë mbajtur 4 aktivitete sociale ku fëmijët patën rastin të luajnë, shoqërohen dhe të shkëmbejnë ide së bashku.

Gjatë gjithë kohës së mbajtjes së Access-it, koordinatorët nga KEC kanë asistuar në logjistikë, në kryerjen e aktiviteteve sociale, si dhe në përgjithësi për mbarëvajtjen e programit Access.

Vështirësitë e hasura në implementim kryesisht kanë qenë të natyrës logjistike, gjegjësisht të gjetjes së orarit të përshtatshëm për të gjithë fëmijët. Planifikimi i orarit për mësim ishte një nga vështirësitë më të mëdha që kemi hasur . Nxënësit ishin nga shkolla të ndryshme me orare të ndryshme mësimi. Sidoqoftë kemi arritur disi që t'i sistemojmë të gjithë fëmijët të cilët janë zgjedhur për të ndjekur orët e ACCESS-it. Vështirësi tjetër ka qenë mosinteresimi i nxënësve serbë për ti vijuar orët me rregull.

13. MONITORIMI I IMPLEMENTIMIT TË STRATEGJISË RAE

Hyrje. – Strategjia për integrimin e komuniteteve rom, shkali dhe egjiptian në arsim është njëri nga komponentët e një strategjie më gjithë përfshirëse për integrimin e këtyre komuniteteve në Kosovë, e cila strategji është duke u zhvilluar me mbështetjen e Zyrës së Kryeministrit të Kosovës. Hartimi i strategjisë në fushën e arsimit është sponsoruar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe është përkrahur nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur.

Procesi i zhvillimit të komponentës së arsimit është koordinuar nga Qendra për Arsim e Kosovës dhe ky proces është karakterizuar me pjesëmarrje të gjerë të të gjitha palëve me interes: Qeverisë, përfaqësuesve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, shoqërisë civile, partive politike, organizatave ndërkombëtare që merren me të drejtat e njeriut dhe fëmijës, etj ku të gjitha palët u angazhuan dhe bënë përpjekje të vazhdueshme për të arritur pajtim për të gjitha çështjet thelbësore.

Qëllimi i përgjithshëm është që ti kontribuojë integrimit të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë duke i ndihmuar komunitetet të përmirësojnë arritjet e tyre në arsim.

Objektivat dhe aktivitetet e Projektit.– Qëllimi i projektit është *të lehtësojë implementimin e Strategjisë për integrimin e komuniteteve rom, shkali dhe egjiptian në arsim duke mobilizuar organizatat e shoqërisë civile për të monitoruar procesin implementues në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe autoritetet lokale të arsimit.*

Aktivitetet e projektit:

- **Themelimi i grupit për Monitorim të Strategjisë** – Identifikimi i një numri të organizatave për pjesëmarrje në procesin e monitorimit. Emërimi i zyrtareve të MASHT për pjesëmarrje në këtë proces. 25 pjesëmarrës e përbëjnë Ekipin për Monitorim ndërsa 5 pjesëmarrës zgjidhen në Komisionin për Monitorim.

- **Organizimi i trajnimit** ” Edukimi për të Drejtën Shoqërore “ – përzgjedhja e 25 personave për përcjelljen e këtij trajnimi të organizuar në formë të dy seminareve.
- **Hartimi i Kornizës së monitorimit -** Organizimi i një punëtorie tre ditore për hartimin e Kornizës së Monitorimit të Strategjisë RAE në arsim.
- **Përgatitja e raporteve të monitorimit** – Bazuar në kornizën e hartuar për monitorim, Komisioni për Monitorim përgatit metodologjinë për shkrimin e raporteve të monitorimit. Raportet prezantohen dhe diskutohen në publik.
- **Organizimi i diskutimeve publike** – Në shtatë Rajonet e Kosovës organizohen shtatë diskutime publike në formë të tryezave të rrumbullakëta apo debati në radio ose TV.
- **Organizimi i aktiviteteve të përbashkëta për fëmijë dhe të rinj të komuniteteve RAE** – Në 7 Rajonet e Kosovës organizohet nga një aktivitet social me pjesëmarrje të komuniteteve RAE.

Të arriturat kryesore të Projektit.- Aktivitetet e projektit janë zhvilluar dhe kanë përfunduar gjatë vitit 2008:

1. Themelimi i grupit për monitorim: Hapi i parë në projekt ka qenë identifikimi i organizatave të shoqërisë civile të cilat do të merrnin pjesë në procesin e monitorimit. Përzgjedhja e anëtarëve për hartimin e kornizës së monitorimit u bë duke formuar një grup prej 20 personave.

Po ashtu MASHT u përfshi në përzgjedhjen e anëtarëve të grupit për monitorim dhe një grupi më të vogël prej 5 personave për monitorimin e kësaj strategjie. Grupin e monitorimit e përbëjnë: një anëtarë nga MASHT, një nga KEC dhe tre përfaqësues të organizatave civile. Përgjegjësia kryesore e Komisionit për Monitorim është të drejtojë procesin monitorues dhe të informojë publikun për progresin në implementimin e Strategjisë.

2. Organizimi i trajnimit: Grupi i përzgjedhur për monitorim ka ndjekur trajnimin gjashtë ditor të ndarë në dy module “ Edukimi për të drejtën shoqërore”.

Objektiva e këtij moduli është që të ndihmojë pjesëmarrësit të tejkalojnë paragjykimet personale për komunitetet tjera. Ky program trajnimi ka për qëllim krijimin e vetëdijes kritike për të njohur diversitetin kulturor, gjuhësor dhe etnik si vlerë njerëzore.

Të dy modulet kanë zgjatur nga tri ditë. Në modulin e parë, pjesëmarrësit janë ballafaquar me " Ndërtimin e vetëdijes kritike", ndërsa në të dytin me " Reflektimin ndaj veprimit". Pas trajnimit gjashtë ditor, të gjithë pjesëmarrësit janë pajisur me certifikata.

3. Hartimi i kornizës së monitorimit: Një punëtori tre ditore është organizuar për hartimin e kornizës së monitorimit të Strategjisë për Integrimin e RAE-ve në arsim. Dokumenti përfshin monitorimin e masave strategjike dhe objektivave strategjike. Kjo kornizë do të shërbejë si udhërrëfyes për monitorimin e Strategjisë.

4. Përgatitja e raporteve të monitorimit: Bazuar në kornizën e hartuar për monitorim, Komisioni për Monitorim ka përgatitur metodologjinë për shkrimin e raporteve të monitorimit. Raporti i parë i monitorimit është bërë në fund të muajit qershor ndërsa i dyti në fund të muajit dhjetor. Për të dy raportet janë mbajtur edhe diskutime publike ku më parë është bërë prezantimi i raporteve e më pas debati rreth prezantimit dhe mundësisë për përmirësim të integrimit të këtyre komuniteteve. Pas çdo debati publik, raportet janë dorëzuar në MASHT.

5. Organizimi i diskutimeve publike – Organizimi i diskutimeve publike është bërë në forma të ndryshme. Në të gjitha rajonet e Kosovës është e planifikuar një diskutim i tillë. Në kuadër të këtij projekti janë mbajtur disa diskutime një në Prizren dhe dy në Prishtinë. Këto kanë qenë debate televizive të shkëputura nga aktivitetet e ndryshme të cilat janë bërë gjatë implementimit të projektit. Parashihen edhe disa debate tjera në radio dhe në formë të tryezave të rrumbullakëta të cilat do të mbahen në muajin janar të vitit 2009, para përfundimit të projektit.

6. Organizimi i aktiviteteve të përbashkëta për fëmijë dhe të rinj të komuniteteve RAE. Janë mbajtur gjithsej gjashtë aktivitete sociale në gjashtë Rajonet e Kosovës. Të gjitha aktivitetet kanë pasur qëllim socializimin e fëmijëve dhe integrimin e tyre në shoqëri. Formën e zhvillimit të këtyre aktiviteteve i kanë zgjedhur vet fëmijët në bashkëpunim me mësuesit e tyre. Aktivitetet janë mbajtur në Pejë, Gjakovë, Ferizaj, Mitrovicë, Prishtinë dhe Gjilan.

Sugjerime për përmirësim në të ardhmen.– Duke ditur se Strategjia për Edukimin e komuniteteve RAE është zhvilluar në bashkëpunim me MASHT dhe i cili është aprovuar nga Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, krijon mundësi që qëndrueshmëria e projekteve të tilla të jetë evidente. Ky dokument i Strategjisë është po ashtu në interes të madh për Qeverinë e Kosovës që të participojë aktivisht në zhvillimin dhe Monitorimin e kësaj Strategjie, duke ditur se një gjë e tillë veçse ka filluar dhe se tani është më lehtë për ta kontrolluar duke ditur se korniza e monitorimit është model për vazhdimin e një procesi të tillë.

14. MENTORIMI I PROJEKTEVE PËR PËRKRAHJE TË ARSIMIMIT TË KOMUNITETEVE RAE

Hyrje. – Strategjia për integrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në arsim është njëra ndër komponentët e një strategjie gjithëpërfshirëse për integrimin e këtyre komuniteteve në Kosovë, e cila është duke e hartuar nën mbikëqyrjen e Zyrës së Kryeministrit të Kosovës. Hartimi i strategjisë në fushën e arsimit është sponsoruar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) dhe është përkrahur nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur (KFOS). MASHT e ka aprovuar zyrtarisht dokumentin. Kështu, si pjesë e kontributit në fushën e arsimimit të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian dhe integrimit të tyre në shoqërinë kosovare, në vitet 2006-2007, KFOS ka mbështetur tri projekte të realizuara nga këto organizata joqeveritare: Shoqata "Durmish Aslano" në Prizren, OJQ "Qendra e Komunitetit Ashkali" në Dubravë dhe Bethany Christian Services (BCS) në Gjakovë.

Objektivat dhe aktivitetet e Projektit.– Objektivë kryesore e këtij projekti është *përmirësimi i kapaciteteve implementuese të të tri organizatave që zbatojnë projektet për përkrahje të arsimimit të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.* Aktivitetet e projektit janë:

- Raportimi mujor i qendrave
- Vizitat në terren
- Organizimi i takimeve në mes të Qendrave
- Trajnimi i mësimdhënësve që punojnë në Qendra
- Trajnim me mësimdhënësit e shkollave publike
- Shtypi i një fletëpalosjeje

Të arriturat kryesore të Projektit.– Projekti është realizuar gjatë vitit 2008, ndërsa të arriturat kryesore ishin:

- Organizatat joqeveritare: Shoqata "Durmish Aslano" në Prizren, OJQ "Qendra e Komunitetit Ashkali" në Dubravë dhe Bethany Christian Services (BCS) në Gjakovë, është dashur për çdo fundmuaj të paraqesin një lloj raporti për punën dhe zhvillimin e aktiviteteve. Këto raporte janë shkrirë në një raport të vetëm që ka qenë një pasqyrë e mirë e zhvillimit të projektit. Raporti, ka qenë edhe një lloj "mbikëqyrësi / stimuluesi" që aktivitetet të zhvillohen në kohën e paraparë.
- Vizitat në terren të organizuara nga KEC, kanë pasur për qëllim vështrimin nga afër të zhvillimit të aktiviteteve. Cak i këtyre vizitave nuk kanë qenë vetëm OJQ-të implementuese e projektit, mirëpo të gjitha palët përfituese, partnerët, me fjalë tjera të gjitha palët e përfshira. Kjo gjithashtu ka ndihmuar që të kemi një pasqyrë më reale të mbarëvajtjes së aktiviteteve.
- Si e arritur tjetër e këtij projekti është organizimi i disa takimeve të përbashkëta me përfaqësuesit e tri qendrave, përkatësisht tri OJQ-ve, implementuese të projektit. Gjatë këtyre takimeve ka pasur shkëmbim të përvojave dhe kanë dalë iniciative të reja për ta zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme që kontribuojnë në fushën e arsimit për komunitetet RAE.
- Në përmbushjen sa më të mirë të objektives së këtij projekti ka ndikuar organizimi i trajnimeve, qoftë me stafin e qendrave/OJQ-ve, ashtu edhe me mësimdhënësit tjerë të shkollave publike që punojnë me fëmijët e komuniteteve RAE. Këto

trajnime kanë ndikuar në ngritjen e kapaciteteve të këtyre qendrave, dhe në të njëjtën kohë i kanë pajisur ata me njohuri për metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe kanë kontribuar në zhdukjen dhe zvogëlimin e paragjykimeve, stereotipave dhe diskriminimit. Për këtë qëllim në kuadër të këtij projekti, dhe në kuadër të kësaj fushate kundër diskriminimit dhe segregacionit është hartuar dhe publikuar një fletëpalosje.

Sugjerime për përmirësim në të ardhmen.– KFOS ka mbështetur këto projekte edhe gjatë vitit 2006 / 2007. Treguesit e arritshmerisë në vitin 2008, kur këto projekte janë përcjellur edhe me disa aktivitete shtesë, me qëllim ngritje të kapaciteteve, si dhe me një lloj monitorimi të përhershëm, janë shumë më të lartë se sa të viteve të kaluara, së paku një gjë të tillë e kanë thënë edhe vetë implementuesit e këtyre projekteve dhe përfituesit. Andaj, sugjerimi ka të bëj me vazhdimësinë e monitorimit të punës së këtyre OJQ-ve në kuadër te këtij projekti. Ky sugjerim shkon njëtrajtësisht me mundësinë e KFOS që të vazhdoj prapë t'i përkrah këto projekte.

15. DHUNA NË MES TË BASHKËMOSHATARËVE

Hyrje. – Dhuna në mes të fëmijëve përmban spektër të gjerë të sjelljeve agresive: zgjidhja e dhunshme e konfliktit, shprehje jo adekuate e hidhërimit ose frustrimit dhe incidentet serioze të cilat gjithnjë sjellin dëme të mëdha për atë që ushtron dhunë e po ashtu edhe për viktimën. Hulumtimet e bëra në shumë shtete kanë dhënë rezultate që rreth 15-20% e fëmijëve janë vazhdimisht viktima të dhunës.

Duke pasur parasysh gjithë këto, Fondacioni "Together" nga Sllovenia si partner në implementim me Qendrën për Arsim e Kosovës kanë realizuar projektin e ashtuquajtur "Peer violence" apo "Dhuna ndaj bashkëmoshatarëve". Në proces të zbatimit të këtij projekti, studentë e profesorë të Departamentit të Psikologjisë nga Universiteti i Prishtinës kanë qenë gjithashtu të përfshirë në projekt. Projekti ka filluar të zbatohet nga shkurti i vitit 2009 dhe do të zgjas deri në shkurt të vitit 2010.

Objektivat dhe aktivitetet e Projektit.– Objektivat e projektit janë:

- Të identifikohen format e manifestimit të dhunës dhe të ngrihet vetëdija për format e dhunës përmes nxënësve dhe mësimdhënësve.
- Të ndërtohet një pasqyrës reale tek fëmijët për pasojat e dhunës.
- Të gjinden forma të zhvillimit të rrugëve të ndryshme për shuarjen e manifestimit të dhunës.
- Të themelohet një sistem përkrahës për ata që vuajnë nga dhuna.

Për ti arritur këto objektiva, në kuadër të këtij projekti janë zhvilluar disa aktivitete si: përgatitja e materialit të trajnimit, seminare për trajnimin e trajnerëve në këtë fushë, aktivitete vazhduese në shkollat pjesëmarrëse të projektit dhe monitorim i gjendjes së kësaj problematike në shkollat tona. Fillimisht është bërë përzgjedhja e shkollave të cilat edhe kanë qenë pjesë e projektit e ato janë: "Asim Vokshi", "Gjergj Fishta", "Hasan Prishtina", Ganimete Tërbeshi", "Mitrush Kuteli", "Dardania", "Zenel Hajdini", Nazim Gafurri", "Hilmi Rakovica" dhe "Iliria". Përzgjedhja e këtyre shkollave është bërë në bashkëpunim me Drejtorinë Komunale të Arsimit në

Prishtinë. Shkollat e përmendura janë shkolla të cilat kanë numër të madh të nxënësve ku supozohet se dhuna ndaj bashkëmoshatarëve është më evidente, por edhe shkolla ku kjo lloj dhune është prezente gjatë gjithë kohës.

Përfitues të këtij projekti janë:

- 30 mësimdhënës nga 10 shkollat e përzgjedhura të projektit;
- 5 Psikologë dhe psikiatër nga Kosova;
- Mësimdhënës, nxënës dhe prindër;

Të arriturat kryesore të Projektit.– Gjatë vitit 2009 janë shënuar këto të arritura:

Përgatitja e materialit të trajnimit.- Materiali i trajnimit është bërë nga ana e ekspertëve nga Sllovenia. Ky doracak është produkt në mes të Fondacionit "Together" dhe "Sdantip" (Organizatë Edukative) nga Sllovenia. Qëllimi i tyre ishte që të ju ndihmoj mësimdhënësve në punën me nxënës, me qëllim që të arrihet ngritje më e lartë e vetëdijes për dhunën ndaj bashkëmoshatarëve dhe ta ndalojnë manifestimin e dhunës në shkolla. Doracaku është i ndarë në dy pjesë. Në pjesën e parë, respektivisht manuali i parë i cili është përdorur për trajnim ka të bëj me njohjen rreth karakteristikave të dhunës, faktorët që ndikojnë tek individi për tu bërë viktimë, dhe identifikimi i dhunës nga ana e mësimdhënësve dhe nxënësve. Ndërsa pjesa e dytë e doracakut ka të bëj me mësimin se si të ballafaqohemi me dhunën, si të punohet me viktimat dhe metodat të cilat duhet të përdoren për zgjidhjen e konfliktit ndaj dhunës së bashkëmoshatarëve.

Trajnimi për trajnerë.- Trajnimi për trajnerë është mbajtur nga ekspertë slloven të cilët kanë eksperiencë në fushën e dhunës ndaj bashkëmoshatarëve. Qëllimi i seminarit ishte që të formohet një grup trajnerësh nga Kosova të cilët do të jenë në gjendje që edhe më tutje të mbajnë trajnime në shkollat e Kosovës ku kërkohet intervenim për këtë lloj problematike. Për këtë qëllim janë zgjedhur 30 mësimdhënës nga shkollat e grupit të synuar të cilët kanë zhvilluar aftësi të nevojshme se si të punohet me mësimdhënësit tjerë në shkollat e tyre. Duke u bazuar në kërkesat e kontratës, trajnimi për trajnerë është ndarë në dy pjesë duke punuar nga tri ditë radhazi. Pas përfundimit të trajnimit, të gjithë pjesëmarrësit të cilët kanë treguar interes dhe përkushtim për punë të mëtutjeshme, janë certifikuar nga Fondacioni "Together" si trajnerë të këtij programi.

Aktivitetet në shkolla.- Pas trajnimit të trajnerëve janë organizuar punëtori në shkollat përfituese me mësimdhënësit e tjerë të po këtyre shkollave dhe nxënësit e tyre. Trajnerët kanë pasur obligim të mbajnë nga gjashtë punëtori me kolegët e tyre, respektivisht një punëtori në muaj. Mësimdhënësit të cilët kanë ndjekur këto trajnime kanë arritur shkathtësi në metodologji dhe tani ata kuptojnë më mirë natyrën e formave të ndryshme të dhunës, llojet e dhunës, sjelljet se si kuptohen nxënësit kur janë ushtrues dhune ose viktimë, etj. Numri i mësimdhënësve nga dhjetë shkollat e përzgjedhura në projekt, është: 409 mësimdhënës. Mësimdhënësit e trajnuar kanë pasur obligim që njohuritë e tyre ti transmetojnë edhe tek nxënësit. Për këtë qëllim janë organizuar edhe gjashtë punëtori në secilën shkollë, punëtori me nxënës. Nga dhjetë shkollat e përzgjedhura në projekt, numri i nxënësve të përfshirë në këto punëtori është: 6856.

Monitorimi.- Procesi i monitorimit ka qenë i vazhdueshëm. Të gjitha shkollat e përfshira në projekt janë monitoruar dhe ndihmuar nga udhëheqësi i projektit dhe një

grup psikologësh dhe psikiatër nga Kosova. Ata janë: Aliriza Arenliu, Shukrije Statovci, Afërdita Uka, Kaltrina Kelmendi dhe Teuta Halimi. Ndihma e tyre dhe përkushtimi i tyre në punë të vazhdueshme me shkollat ka bërë që projekti të ketë rezultate të mëdha dhe dëshirë për të vazhduar edhe më tutje me projekte të tilla.

Sugjerime për përmirësim në të ardhmen.– Projekti "Dhuna ndaj bashkëmoshatarëve" ka filluar të zbatohet nga muaji shkurt i vitit 2009 dhe do të zgjas deri në shkurt të vitit 2010. Duke pasur parasysh se në këtë projekt nuk kanë qenë të përfshira të gjitha komunat e Kosovës por vetëm komuna e Prishtinës, mendojmë se do të ishte mirë që projekti të zgjerohet edhe në komunat tjera. Fondacioni "Together" nga Sllovenia ka ndihmuar që në Kosovë të hapet edhe një fondacion i njëjtë i cili do të vazhdojë edhe në vitin e ardhshëm projektin e njëjtë duke përfshirë disa komuna tjera në Kosovë. Bashkëpunimi i KEC me Fondacionin "Together" nga Sllovenia dhe Kosova, që tani kanë filluar bisedat për mundësitë e vazhdimit të këtij projekti në vitet në vijim.

16. MONITORIMI I MENAXHIMIT TË FINANCAVE KOMUNALE TË ARSIMIT NË 5 KOMUNA TË KOSOVËS

Hyrje. – Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) në bashkëpunim me donatorë si: BTD, ESP, ATRC, UNESCO, etj., në periudhën 2005-2008 ka implementuar disa projekte të cilat i kanë kontribuar vetëdijësimit të qytetarëve për rrezikun që shkakton korrupsioni në pengimin e zhvillimit të shoqërive demokratike. Disa nga këto projekte kanë qenë:

- Edukimi kundër korrupsionit,
- Edukimi, themelimi dhe monitorimi i strukturave që luftojnë korrupsionin,
- Transparenca, etika dhe masat anti-korrupsion në arsim.

Përvoja në implementimin e këtyre projekteve bëri që KEC të vazhdojë realizimin e projekteve anti-korrupsion. Kështu në shtator të vitit 2009, KEC filloi implementimin e projektit "Monitorimi i menaxhimit të financave komunale të arsimit në 5 komuna të Kosovës".

Ideja për realizimin e këtij projekti u iniciua nga fakti se pothuajse të gjitha DKA zotojnë mjete për aftësimin profesional të mësimdhënësve, por vetëm një numër simbolik i tyre organizojnë trajnime. Në këtë rast shtrohen pyetjet: Çfarë ndodh me të hollat që alokohen për trajnime? Nëse nuk shfrytëzohen për aftësim profesional të mësimdhënësve, atëherë ku ridrejtohen ato? Si menaxhohet buxheti i DKA dhe a menaxhohet si duhet?

Pikërisht për të gjetur përgjigje në këto pyetje, KEC ka filluar implementimin e projektit "Monitorimi i menaxhimit të financave komunale të arsimit në 5 komuna të Kosovës". Meqë projekti realizohet për herë të parë është parë e arsyeshme të fokusohemi në 5 komuna: në Prishtinë, në Gjilan, në Gjakovë, në Istog dhe në Vushtrri. Zgjedhja e tillë e komunave nuk ka qenë e rastësishme. Janë zgjedhur 2 komuna (Gjilan dhe Istog) në të cilat është duke u impelementuar procesi i decentralizimit të sistemit të arsimit dhe 3 komuna (Prishtina, Gjakova dhe Vushtria) në të cilat ende nuk implementohet ky proces. Kjo ndihmon që të analizohet menaxhimi i buxhetit në komunat e caktuara, por mundëson edhe krahasimin e

menaxhimit të financave të DKA të komunave që zbatojnë procesin e decentralizimit dhe atyre që nuk e zbatojnë atë.

Objektivat dhe aktivitetet e Projektit.– Synimi i projektit është të sigurohet një shkallë e lartë e transparencës në menaxhimin financiar në nivelin komunal të arsimit, përmes krijimit të "masës kritike" të qytetarëve dhe raportimit për rastet eventuale të keqpërdorimit të parasë publike.

Mungesa e transparencës në menaxhimin financiar të shpenzimeve publike ndikon në humbjen e besimit të qytetarëve në udhëheqjen komunale dhe mos pagimin e taksave nga ana e tyre. Prandaj për të siguruar një qëndrueshmëri të sistemit të decentralizuar të menaxhimit financiar është e domosdoshme rritja e shkallës së transparencës për shpenzimet publike. Po ashtu është e nevojshme të krijohet një masë kritike e qytetarëve (watchodgs), të cilët do të jenë aktivë në mbikëqyrjen e menaxhimit financiar dhe shpenzimin e të hyrave komunale.

Qëllimi i projektit është të krijohet një marrëdhënie e llogaridhënies dhe mbikëqyrjes në mes të administratës publike dhe qytetarëve.

Administrata publike duhet të jetë e lidhur me përfituesit e shërbimeve të tyre. Ajo duhet të jetë e hapur për përfshirjen e palëve të interesit në procesin e planifikimit, si dhe të mos pengojë iniciativat e qytetarëve për kontroll në fazën e realizimit të aktiviteteve. Krijimi i një klime të tillë do të rriste efikasitetin e administratës publike dhe sigurimin e një vazhdimësie në udhëheqje.

Të arriturat kryesore të Projektit.– Projekti ka filluar në shtator të vitit 2009 dhe do të vazhdojë deri në qershor të vitit 2010. Gjatë vitit 2009, në kuadër të këtij projekti janë realizuar këto aktivitete:

1. Përgatitja e kornizës për monitorim.- KEC në bashkëpunim me palët me interes ka mbajtur më 25 shtator 2009 një punëtori në të cilën janë identifikuar fushat e monitorimit, treguesit e monitorimit, si dhe instrumentet për monitorim. Informacionet nga kjo punëtori kanë shërbyer në përpilimin e kornizës për monitorim.

2. Aftësimi i 15 monitorëve, nga 3 për secilën nga 5 komunat.- KEC ka përzgjedhë nga 3-monitorë për secilën nga 5 komunat. Për monitorët janë mbajtur tri seminare:
   - Korrupsioni – kuptimi, format e manifestimit dhe strategjitë për luftimin e tij.
   - Financat qendrore dhe lokale – grumbullimi dhe shpenzimi me theks të veçantë në financat në arsim.
   - Korniza e monitorimit – aspekte praktike të monitorimit.

Seminari i parë është mbajtur më 10-11 tetor, i dyti më 17-18 tetor, ndërsa seminari i tretë më 25 tetor. Gjatë seminarit të tretë, monitoruesve iu shpërnda korniza e monitorimit, si një udhërrëfyes për të realizuar procesin e monitorimit.

3. Shpërndarja e pyetësorit në 20% të shkollave në 5 komunat e cekura dhe mbledhja e pyetësorëve.- Gjatë seminarit të tretë në mënyrë transparente (me short) janë përzgjedhur dhe shkollat në të cilat do të shpërndahej pyetësori për plotësim. Në

secilën nga komunat është caktuar mostra prej 20% të shkollave (pra mesatarisht nga 6 shkolla për komunat: Gjilan, Vushtrri, Gjakovë dhe Istog, ndërsa 9 shkolla në komunën e Prishtinës). Pyetësori është kërkuar të plotësohet nga drejtorët e shkollave të përzgjedhura, kryetarët e këshillave të shkollave dhe 20% e personelit mësimor të shkollave të përzgjedhura. Pyetësorët janë shpërndarë gjatë muajit nëntor. Në muajin dhjetor është bërë futja e të dhënave dhe analiza e rezultateve të pyetësorëve. Ekipet e monitorëve do raportojnë rezultatet sipas komunave në fillim të muajit janar 2010.

Sugjerime për përmirësim në të ardhmen.– Realizimi i projektit ka hasur në vështirësi të shumta. Përfshirja e drejtorëve të shkollave dhe shumë mësimdhënësve në fushatën zgjedhore të zgjedhjeve lokale, të cilat zgjatën më shumë se që është planifikuar solli probleme në pranimin e monitorëve dhe plotësimin e pyetësorëve. Në anën tjetër, përkundër faktit se KEC ka nënshkruar një marrëveshje mirëkuptimi me drejtorët e DKA të 5 komunave ku implementohet projekti, disa nga monitorët nuk kanë qenë të mirëpritur në zyrat e drejtorive arsimore. Në këtë ka ndikuar dhe periudha e fushatës zgjedhore, ku përfaqësuesit e DKA kanë hezituar të japin informacionet e kërkuara nga monitorët. Në të ardhmen duhet të parashihen vizita të koordinatorit të projektit në DKA e 5 komunave ku implementohet projekti në mënyrë që t'iu ndihmohet monitorëve në kryerjen e detyrave të tyre.

17. AVANCIMI I MËSIMDHËNIES SË HISTORISË

Hyrje. – Përfundimi i shpërbërjes së ish-Jugosllavisë dhe krijimi i shteteve të reja në Ballkan në njërën anë, si dhe përafrimi me frymën e Bashkimit Evropian në anën tjetër, sjell domosdoshmërinë e bashkëpunimit rajonal dhe shmangies së barrierave në mes të kombeve. Krijimit të një fryme bashkëpunimi, paqeje dhe mirëkuptimi në mes të vendeve në rajon mund t'i kontribuojë dhe mësimi i lëndës së Historisë përmes përfshirjes së temave që kanë për qëllim kultivimin respektit reciprok mes kombeve.

Në Kosovë është krijuar një frymë ideale për implementimin e një projekti të tillë. Qeveria e Kosovës po ndërton një politikë të tolerancës ndëretnike, të bazuar në interesat e qytetarëve pa dallim nga përkatësia etnike apo religjioze. Bashkëpunimi me fqinjët është në agjendën politike të qeverisë, prandaj kjo situatë duhet të shfrytëzohet dhe t'i jepet impuls përmes ndërmarrjeve të ndryshme në fushën e arsimit.

Objektivat dhe aktivitetet e Projektit.**–** Synimi i përgjithshëm i këtij projekti është *Të krijohet një klimë e re në mësimin e lëndës së historisë, përmes trajtimit krahasues të fakteve historike që ndërlidhen me marrëdhëniet mes popujve të Ballkanit.*

Qëllimi: *të ndërtohen kapacitete në mesin e mësimdhënësve të historisë për të përfshirë burime historike nga vende të ndryshme, në shtjellimin e temave historike të caktuara.*

Aktivitetet e projektit në vitin 2008

Në kuadër të këtij projekti janë paraparë të zhvillohen këto aktivitete

1. Organizimi i trajnimit për trajnerë
2. Ofrimi i materialeve shtesë për secilin pjesëmarrës në trajnim, të cilat ndihmojnë shtjellimin e njësive të caktuara që janë pjesë e plan-programit të lëndës së Historisë:
    - Perandoria Osmane
    - Kombet dhe shtetet ne Evropën Juglindore
    - Luftërat Ballkanike
    - Lufta e Dytë Botërore
3. Certifikimi i trajnerëve

<u>Aktivitetet e projektit në vitin 2009</u>

1. Organizimi i trajnimit në Prizren në muajin shkurt.
2. Zhvillimi ideve të reja, për të siguruar vazhdimësinë e projektit
3. Angazhimi i dy eksperteve ndërkombëtarë për metodologji të mësimdhënies, për të hartuar doracakun e trajnimit
4. Hartimi i Doracakut dhe programit të trajnimit
5. Përkthimi i doracakut në gjuhën shqipe dhe boshnjake.

Të arriturat kryesore të Projektit.– Në qershor vitit 2008 u mbajt trajnimi i parë në kuadër të këtij projekti. Qëllimi i këtij trajnimi ishte, prezantimi i kompletit të librave alternative për mësimin e lëndës së Historisë, si dhe prezantimi i disa mësimeve model, mësime këto të hartuara në bazë të teksteve bazike dhe atyre alternative. Çështja e mënyrës së të shkruarit dhe interpretuarit të historisë në Ballkan është një çështje mjaft e ndjeshme, andaj, ky trajnim u shikua me një skepticizëm nga pjesëmarrësit sado që këto libra janë vetëm libra alternative. Megjithatë, kontributi i pjesëmarrësve dhe në përgjithësi komentet karshi këtyre librave ishin pozitive.

Në muajin dhjetor të viti 2008, u organizua edhe një trajnim për trajnerë, me qëllim që pjesëmarrësit të ngritën në nivelin e trajnerit, dhe njohuritë e fituara pastaj t'i zbatojnë në trajnimet e ardhshme. Në këtë trajnim morën pjesë 26 mësimdhënës, pjesa dërmuese e tyre mësimdhënës të lëndës së historisë, mirëpo kishte edhe disa student që janë duke i zhvilluar studimet master në lëmine e historisë.

Në muajin shkurt të vitit 2009, në Prizren u organizua edhe një trajnim tjetër me mësimdhënësit e historisë të kësaj komune. Edhe pse ishte e paraparë që trajnimi të zhvillohet me 25 mësimdhënës të historisë, ishte befasuese që në trajnim morën pjesë 34. Trajnimi kaloi në frymë shumë pozitive, librat e prezantuar ishin një risi për shumicën e mësimdhënësve.

Në bashkëpunim me partnerin implementues u hartua një projekt i ri, ku fokusi kryesor binte në metodologjinë e mësimdhënies së historisë. Projekti ka gjetur përkrahjen e donatorëve dhe në tetor ka filluar implementimi. Deri më tani janë zhvilluar këto aktivitete:

- Janë angazhuar dy ekspertë ndërkombëtarë për metodologji të mësimdhënies, për të hartuar doracakun e trajnimit
- Është hartuar Doracaku dhe programi i trajnimit
- Është përkthyer doracaku në gjuhën shqipe dhe boshnjake.

Përfundimi.– Trajnimi u vlerësua mjaft shumë nga pjesëmarrësit, madje, u shfaq kërkesa edhe për trajnime tjera të ngjashme. Karakteristikë e këtij trajnimi ishte bashkëpunimi shumë i mire në mes të pjesëmarrësve dhe trajnerëve.

Edhe pse çështja e mënyrës së shkrimit dhe interpretimit të historisë në vendet e Ballkanit është një çështje mjaft e ndjeshme, pjesëmarrësit në këtë trajnim u treguan shumë mendjehapur dhe duhet çmuar maksimalisht komentet, inputet, sugjerimet dhe debatet e zhvilluara gjatë gjithë kohës. Është shumë me rëndësi që me ndihmën e donatorëve është siguruar qëndrueshmëria e këtij projekti. Gjatë vitit 2010 do të organizohen edhe një varg aktivitetesh të tjera, me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të mësimdhënësve të historisë.

18. QASJA TËRËSEKTORIALE NË ARSIM

Hyrje. – Në maj të vitit 2009, Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian (ECLO) në Prishtinë shpalli tender për projektin 3-vjeçar "Përkrahja për implementimin e qasjes tërësektoriale në arsimin e Kosovës" me qëllim që t'i ofrojë ndihmë Qeverisë së Kosovës për ofrimin e shërbimeve më cilësore në arsim. Në fakt, vet ndihma është pjesë e pakos së përkrahjes IPA 2008 për të ndihmuar aderimin më të shpejtë të vendit në Bashkimin Evropian. Vet tenderi ishte i tipit të kontratës për shërbime me terma

specifike të referencës të hartuara nga ECLO, ndërsa KEC aplikoi si pjesë e konsorciumit të udhëhequr nga Cambridge Education Ltd, duke arritur paraprakisht marrëveshje, që, në rast të fitimit të këtij tenderi, të mbajë përgjegjësinë për organizimin e zyrës së projektit dhe për sigurimin e ekspertizës vendore. Pas shpalljes së rezultatit, kontrata për implementim u nënshkrua në shtator, ndërsa implementimi filloi më 20 tetor 2009.

Objektivat dhe aktivitetet e Projektit.– Si u theksua më sipër, qëllimi kryesor i këtij projekti është *të përkrahet Qeveria e Kosovës në përmirësimin e cilësisë dhe efikasitetit të arsimit dhe shërbimeve të trajnimit, në veçanti në fushën e arsimit parauniversitar, nga këndvështrimi i arsimit gjatë gjithë jetës dhe perspektivës së punësueshmërisë, në harmoni me qasjen e dakorduar tërësektoriale në arsim dhe në përputhje me standardet e BE.*

Projekti ka tri komponenta kryesore:

1) Ndërtimi i kapacitetit.– Ndërtimi dhe forcimi i kapacitetit të MASHT për të menaxhuar sektorin e arsimit, me përkrahje të koordinuar të donatorëve partnerë, si dhe për të parashikuar në mënyrë efektive financimin e sektorit dhe për të monitoruar progresin e implementimit të strategjive në sektorin e arsimit.

2) Zhvillimi i kurrikulit.– Të rishikohet dhe të zhvillohet drafti i Kornizës së Kurrikulit përfshirë ndërtimin e kapacitetit dhe trajnimin e zhvilluesve të kurrikulit dhe palëve të tjera me interes, e në përputhje me nevojat për implementimin e kurrikulit të ri.

3) Trajnimi i mësimdhënësve.– Rishikimi dhe elaborimi i mëtutjeshëm i Standardeve të Mësimdhënies dhe i katalogut të programeve të trajnimit për mësimdhënës, si dhe ndërtimi i kapacitetit për zhvillimin e politikave të trajnimit të mësimdhënësve me qëllim të nxitjes së përmirësimit të cilësisë në arsimin fillor dhe të mesëm në Kosovë.

Për secilin prej këtyre aktiviteteve, me terma të referencës janë paraparë aktivitete të caktuara, të cilat kanë mundur të rishikohen në fazën fillestare. Vet oferta e prezantuar nga Konsorciumi i ka bërë disa ndryshime dhe plotësime, duke parashikuar mundësinë që, pas fillimit të projektit dhe analizës fillestare të situatës të bëhen edhe ndryshime të tjera.

Në total, projekti parasheh 1,150 ditë pune për dy ekspertët kyç dhe 2,206 ditë pune për ekspertë të tjerë, afatshkurtër dhe afatgjatë, prej të cilave 1,318 ditë për ekspertë lokalë.

Të arriturat kryesore të Projektit.– Nga 20 tetori - dita e fillimit të projektit përqendrimi ka qenë në krijimin e Zyrës së Projektit, e cila ka qenë plotësisht funksionale më 8 nëntor, si dhe në analizën fillestare të situatës, e cila ka rezultuar me hartimin e raportit fillestar që është akoma në pritje të aprovimit zyrtar nga ECLO dhe MASHT. Ky raport është hartuar pas konsultimeve në bazë të gjerë me të gjitha palët relevante me interes, përfshirë komunitetin e donatorëve, dhe ofron një plan të zbatueshëm për realizimin e projektit. Pritet që aktivitetet e Projektit të fillojnë menjëherë pas aprovimit të raportit.

19. WBC-INCO.NET

Hyrje. – Duke u nisur nga prioriteti i BE-së për zgjerim në vendet e Ballkanit Perëndimor, ky projekt synon t'i ndihmojë këto vende të ndërtojnë raporte me BE-në dhe në mes vete në fushën e shkencës dhe të teknologjisë. Projekti ka filluar më 1 janar 2008 dhe zgjatë tre vjet. Financimi vihet nga Programi FP7 i Bashkimi Evropian, ndërsa përgjegjës për koordinim është Qendra për Inovacione Sociale (ZSI) me seli në Vjenë. Në realizimin e projektit marrin pjesë 26 institucione partnere nga 18 vende evropiane, në mesin e tyre ministri, agjenci qeveritare, ndërmarrje të vogla dhe të mesme, si dhe organizata joqeveritare.

Objektivat dhe aktivitetet e Projektit.**–** Objektiva e këtij projekti është *të nxitet dialogu ndër-regjional në mes të vendeve të BE,vendeve të asociuara të FP7 dhe atyre të Ballkanit Perëndimor dhe, përmes masave strukturale, të shtohet pjesëmarrja e hulumtuesvfe nga Ballkani Perëndimor në projektet evropiane për shkencë, teknologji dhe zhvillim.*

Projekti ka shtatë komponenta:

WP1: Dialogu Evropian dhe Rajonal,

WP2: Vendosja e prioriteteve për të strukturuar pjesëmarrjen në FP7,

WP3: Monitorimi dhe analiza e bashkëpunimit në fushën e shkencës dhe teknologjisë,

WP4: Ndërtimi i kapacitetit,

WP5: Lehtësimi i rrjetëzimit dhe rritja e pjesëmarrjes në FP7,

WP6: Menaxhimi i projektit,

WP7: Diseminimi.

Secila komponentë koordinohet nga njëri prej partnerëve, ndërsa në kuadër të komponentave, definohen edhe detyrat e punës, ashtu që, secila detyrë koordinohet nga partneri që është përgjegjës për koordinimin e komponentës, ose ndonjë partner tjetër.

Në formë përshkruese, aktivitete më të zakonshme janë:

- definimi i prioriteteve regjionale të kërkimit dhe teknologjisë,
- analiza e mundësive për bashkëpunim,
- organizimi i punëtorive të trajnimit dhe konsultimeve (p.sh. për menaxhimin e hulumtimeve, auditimin financiar dhe treguesit për shkencë dhe teknologji), si dhe evenimenteve që kanë për qëllim ngritjen e vetëdijes,
- përkrahja për pikat nacionale të kontaktit dhe sistemet informative shkencore,
- publikimi i rregullt i letrës informative dhe i revistës në portalin e projektit.

Të arriturat kryesore të Projektit.– Gjatë dy vjetëve të para të implementimit, KEC ka marrë pjesë aktive në komponentat WP2, WP4 dhe WP6, por, shumë shpesh ka kontribuar edhe në realizimin e aktiviteteve që i takojnë komponentave të tjera. Në

kuadër të WP2 janë hartuar raporte nacionale për gjendjen dhe përcaktimin e prioriteteve kërkimore në këto fusha:

- Teknologjia informative dhe komunikuese,
- Garo-ushqimi,
- Shëndetësia,
- Transporti,
- Mbrojtja e mjedisit.

Këto raporte janë hartuar nga ekspertë kosovarë, ndërsa tri të fundit janë prezantuar dhe diskutuar në konferenca të karakterit rajonal që janë mbajtur në Tiranë, Sarajevë dhe Shkup, përkatësisht. Të gjitha raportet janë publikuar dhe shpërndarë përmes ueb portalit të projektit, ndërsa kanë shërbyer edhe si material bazë për Këshillin Kombëtar të Shkencës në procesin e hartimit të Programit Kombëtar të Shkencës.

Në kuadër të komponentës WP4 është siguruar pjesëmarrja e ekspertëve kosovarë në tri konsultime rajonale: për hartimin e projekteve FP7 (Bosnjë), për energji (Turqi), për sistemet informative në shkencë dhe teknologji (Slloveni). Përveç kësaj, është organizuar një trajnim për auditimin financiar në Prishtinë. Pikës nacionale të kontaktit për FP7 i është bërë një vizitë nga përfaqësuesit e ZSI dhe partnerit përgjegjës për këtë detyrë (Ministrisë së Shkencës së Greqisë), që ka shërbyer si hyrje për thellimin e bashkëpunimit me strukturat e BE-së. Po ashtu, është analizuar gjendja e statistikave për shkencë dhe teknologji dhe janë bërë sugjerimet adekuate për përmirësim.

Komponenta WP6 është përqendruar në rrjetëzimin dhe koordinimin në nivel rajonal dhe në kuadër të saj janë organizuar edhe sesione informative dhe trajnime për stafin menaxhues dhe aktorët me përgjegjësi udhëheqëse.

Sugjerime për përmirësim në të ardhmen.– Kosova është vendi i vetëm i Ballkanit Perëndimor që ka statusin e partnerit në FP7, për dallim nga vendet tjera që kanë status më të avancuar. Nga ana tjetër, institucionet e Kosovës po i bëjnë hapat e parë drejt definimit të politikave për zhvillimin e shkencës dhe teknologjisë, prandaj projektet si ky ofrojnë një përkrahje mjaft të dobishme për të përshpejtuar integrimin në Hapësirë Kërkimore Evropiane. Është me rëndësi që, në të ardhmen, të sigurohet pjesëmarrja formale e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në këto rrjetëzime, sepse kështu nxitet dialogu dhe bashkëpunimi regjional.

20. INFORMIMI DHE PUBLIKIMET

Sektori për Informim dhe Publikime është krijuar në bazë të dokumentit Strategjia e Veprimit të KEC 2006-2008. Ideja e krijimit të këtij sektori është mbështetur në nevojën për të siguruar: përfaqësim më të madh të KEC në publik dhe intensifikim të kontaktit me median dhe publikun lidhur me aktivitetet e KEC; dhe, rritje të numrit të publikimeve nga KEC dhe menaxhim adekuat të tyre. Sektori për Informim dhe Publikime praktikisht ka filluar të funksionojë në nëntor të vitit 2005 me angazhimin e një personi në pozitën e Zyrtarit për Informim dhe Publikime.

Ky Sektor ka për qëllim të përmbushë njërën nga objektivat strategjike të KEC - *të sigurohet qarkullimi funksional i informacionit për qasje inovative dhe për ndryshime në arsim dhe në shoqëri*.

Aktivitetet ditore dhe ato periodike të sektorit janë: pasqyra e shtypit ditor, diskutimi me stafin e organizatës për çështje të ndryshme të informimit, dërgimi i njoftimeve tek media për ndonjë ngjarje apo për ndonjë organizim të veçantë, plotësimi dhe mirëmbajtja e faqes zyrtare të Internetit të KEC-it, përgatitja për çdo muaj e Letrës Informative, rishikimi dhe rregullimi teknik i materialeve propaganduese dhe i botimeve të KEC-it.

Gjatë periudhës raportuese në Sektorin për Informim dhe Publikime është punuar mjaft shumë që të përmbushen të gjitha objektivat dhe obligimet që i takojnë kësaj zyre. Në vazhdim në mënyrë kronologjike do t'i përmendim disa nga të arriturat në vitin 2009:

1. **Mbajtja e kontaktit të vazhdueshëm me media lidhur me aktivitetet e KEC.** Krijimi i raporteve të mira me media ka pasur impakt mjaft të mirë në pasqyrimin dhe mbulimin e ngjarjeve të organizuara nga KEC. Duhet përmendur se më shumë se 90% të ngjarjeve të organizuara nga KEC, kanë pasur mbulueshmëri të medieve, qofshin ato të shkruara apo elektronike.

2. **Mirëmbajtja e ueb faqes së KEC, në të cilën janë publikuar informacionet e domosdoshme dhe të dhënat me rëndësi për aktivitetet e KEC**. Në bazë të statistikave mujore të nxjerra nga kjo faqe (shih fig. 1) është vërejtur se kjo ueb faqe shfrytëzohet mjaft shumë (mesatarisht 4.000 vizita në muaj). Gjithashtu si tregues suksesi është edhe numri i letrave të vizitorëve që janë pranuar. Mirëmbajtja e kësaj faqeje i ka dhënë një dimension të ri pasqyrimit të aktiviteteve të KEC dhe rritjes së interesimit të opinionit dhe mediave për aktivitetet dhe punën e KEC.

Summary by Month										
Month	Daily Avg				Monthly Totals					
	Hits	Files	Pages	Visits	Sites	KBytes	Visits	Pages	Files	Hits
Dec 2009	1680	1195	292	161	1812	1594542	3706	6727	27492	38651
Nov 2009	1563	1173	257	146	1889	1832575	4392	7710	35201	46915
Oct 2009	1683	1260	267	163	1887	2086514	5077	8292	39075	52179
Sep 2009	1356	1018	223	152	1789	1471806	4577	6695	30561	40706
Aug 2009	1169	832	243	131	1587	1243472	4091	7545	25814	36251
Jul 2009	1135	849	223	147	1361	1289863	4563	6927	26328	35210
Jun 2009	1414	1081	260	175	1519	1620690	5279	7807	32438	42429
May 2009	1200	918	183	127	1571	1475048	3947	5679	28469	37230
Apr 2009	1536	1156	230	134	1606	1663635	4038	6907	34687	46100
Mar 2009	1489	1184	222	137	1669	1775389	4258	6895	36717	46175
Feb 2009	1354	969	244	158	1717	1507384	4436	6846	27152	37923
Jan 2009	1461	1087	251	154	1742	1774276	4790	7802	33699	45302
Totals						19335194	53154	85832	377633	505071

Fig. 1. Statistikat e përdorimit te ueb faqes gjatë vitit 2009

3. **Mirëmbajtja e ueb faqeve tjera**. Zyrtari për Informim gjatë këtij viti është marrë edhe me mirëmbajtjen e ueb faqeve tjera që dalin nga programet e KEC. Gjatë kësaj periudhe janë dizajnuar nga fillimi apo në mënyrë periodike janë pasuruar me informacione të reja këto ueb faqe: www.mileniumi3.net, www.childrights-ks.org, www.apreme.net.

4. **Përgatitja në vazhdimësi (çdo fundmuaj) dhe shpërndarja e Letrës Informative në gjuhën shqipe dhe gjuhën angleze**. Letra Informative është shpërndarë rregullisht në një numër të konsiderueshëm të adresave elektronike. Këtë vit, kjo listë është përditësuar (freskuar) me adresa të reja elektronike të ri. Letra Informative është shpërndarë (e shtypur në letër) në stokun e KEC, ku të gjithë njerëzit që frekuentojnë zyret e KEC kanë mundësi ta shohin dhe ta marrin. Nga lista e atyre që e pranojnë Letrën Informative vazhdimisht kanë arritur letra, qoftë me falënderime, interesim për më shumë informata, apo kërkesa për bashkëpunim, duke pasqyruar në këtë mënyrë efektin pozitiv të Letrës Informative në njoftimin dhe sensibilizimin e bashkëpunëtorëve, mediave dhe opinionit në përgjithësi me punën dhe aktivitet e KEC. Kemi pasur një numër të konsiderueshëm (mesatarisht 5 vetë për muaj) të kërkesës për të hyrë në listën e atyre që e pranojnë Letrën Informative.

   Vështirësi: Në këtë rast, ndonjëherë vështirësi ka qenë grumbullimi i materialeve për publikim në Letrën Informative. Kjo vështirësi ka qenë si pasojë e ngarkesës së madhe të stafit të KEC, ndonjëherë edhe e vetë Zyrtarit për Informim.

5. **Përgatitja dhe shtypi i fletëpalosjeve në shqip dhe anglisht për programet dhe projektet e KEC si dhe materialeve të tjera propagandistike.** Gjatë këtij viti janë shtypur një numër mjaft i madh i fletëpalosjeve dhe informatorëve tjerë për projektet dhe programet e KEC

6. Gjatë këtij viti edhe publikimi i titujve të ri ka zënë një vend të rëndësishëm në punën e KEC. Gjatë viteve 2008 dhe 2009 janë shtypur këto libra:
   - Udhëzuesit për programin MKLSh (1-8)
   - Plani Ditor – është rifreskuar
   - Studimi Akademik
   - Edukimi për Drejtësinë Shoqërore – Manual Trajnimi
   - Barazia gjinore në librat e leximit, në arsimin e detyruar nëntëvjeçar në Kosovë (në dy gjuhë shqipe dhe angleze)
   - "Paqja fillon me mua", libër me punime të nxënësve të shkollës "Mileniumi i Tretë"
   - "Doracak për krijimin e komiteteve shkollore për të drejtat e fëmijës" (ribotim)
   - "Doracak për krijimin e mjediseve të sigurta dhe humane në shoqëri dhe shkolla"

7. Në bashkëpunim të ngushtë Zyra për informim e KEC dhe shkolla “Mileniumi i Tretë”, kanë hartuar dhe publikuar “Fletoren e komunikimit me prindër”. Ky mjet metodologjik do të përmirësoj dukshëm komunikimin me prindër.

8. Zyra për Informim dhe Publikime në kuadër të KEC, gjatë gjithë kohës ka qenë në dispozicion të stafit, d.m.th. ka ndihmuar stafin në përpilimin e dokumenteve, rregullimin e tyre, korrektimin e tyre, si nga ana përmbajtjesore ashtu edhe nga ana pamore. Gjithashtu, ka ndihmuar në organizimin e fushatës për regjistrimin e nxënësve të ri në Shkollën “Mileniumi i Tretë”. Ndihma logjistike në shumë punëtori dhe trajnime që janë organizuar brenda dhe jashtë vendit, si dhe ndihma e kohëpaskohshme në aktivitetet e shkollës “Mileniumi i Tretë”.

21. SHKOLLA JOPUBLIKE "MILENIUMI I TRETË"

Viti shkollor 2008/09 u përmbyll suksesshëm me një varg aktivitetesh: si pjesëmarja e grupit dramatik me pjesën “Ëndrra e një nate vere”, W. Sheakspeare, në finalen e festivalit në San Remo (Itali), pjesëmarrja e 15 bursistëve nga shkolla në kampin veror të Universitetit Amerikan në Bullgari, pjesëmarrja e 5 nxënësve të klasave të shtata në kampin veror në Hungari në projektin “Teaching Tolerance through English”, bashkëpunimi i ngushtë me një shkollë në Calgary (Kanada), botimi i librit me krijime të nxënësve-financuar nga Shkolla, ekskursionet nëpër Kosovë, Maqedoni për të gjitha klasat dhe një pushim i zgjatur rekreativ në Turqi me nxënësit e klasave të pesta e të nënta si dhe mbrëmja e Semi-maturës që demonstruan angazhimin e pjesëtarëve të shkollës me aktivitete jashtëmësimore, të cilat pa dyshim ndikuan në ngritjen e imazhit në përgjithësi. Të gjitha këto dhe të arritura të shumta për plot pesë vjet në shkollën “Mileniumi i Tretë” më së miri vulosën ndryshimet pozitive dhe qëndrueshmërinë e shkollës me shfaqjen e dokumentarit filmik i cili u prezantua në kinemanë ABC për nderë të Ditës së Shkollës, më 1 Qershor.

Viti shkollor që u la pas freskoi imazhin dhe ngriti performancën e shkollës edhe me dy risi: krijimi i sistemit për vlerësimin e nxënësve me teste të jashtme çdo fund të gjysmëvjetorit dhe vlerësimi i performancës së stafit bazuar në përmbushjen e 6 standardeve dhe një mori kompetencash, ku të parat reflektohen në vlerësimin përfundimtar të nxënësve 30%, kurse të dytat reflektohen në pagat e mësimdhënësve sipas performancës së treguar. Këto shërbyen si një sinjal mjaft i mirë se punët në shkollë po venin mbarë si me rezultatet e arritura të nxënësve ashtu edhe me angazhimin e lakmueshëm që po e kryenin shumica e madhe e mësimdhënësve të vlerësuar. Natyrisht, këto ndikuan në krijimin e një klime të rehatshme për punë dhe shtuan ambiciet si të stafit punonjës ashtu edhe të udhëheqjes për përkushtim maksimal në të ardhmen.

Kurse, përgatitjet për vitin vijues 2009/10 filluan që nga muaji prill, me regjistrimet e reja e pranimin e stafit mësimor për të vazhduar gjatë verës me përgatitjen e objekteve me pastrim dezinfektues, ngjyrosje, rregullim të luleve, ndërrim të inventarit dhe pajisjeve të dëmtuara, pastaj ndërrimin e tavolinave e karrigeve për nxënësit e klasave të nënta e të dhjeta me pajisje më të përshtatshme për mësimnxënie, sigurimin e projektorëve për secilën dhomë mësimore, sigurimin e laptopëve personalë për mësimdhënësit, në mënyrë që frutat e punës të bëheshin edhe më të dukshme në fund të vitit kalendarik 2009.

Këtë vit, Shkolla përmbushi përgjithësisht hapësirat e veta prej 3,500 m^2, me ambiente të përshtatshme e të rregulluara, të qeta e të sigurta që i kontribuojnë zhvillimit maksimal të secilit nxënës në përputhje me aftësitë e tij dhe me kërkesat e shoqërisë. Ka dy objekte të cilat funksionojnë një për klasat e HpH-it 1-3 dhe tjetri për klasat 4-10.

Në gjysmëvjetorin e parë, mësimi u organizua me 27 paralele, me gjithsej 493 nxënës prej të cilëve 267 u përkisnin kl. 1-5, kurse 226 nxënës u përkisnin kl. 6-10. Prej tyre 1 nxënës mbeti i pa notuar për shkaqe të definuara shëndetësore dhe i cili duhet t'i nënshtrohet provimeve të klasës në fund të vitit shkollor, me kërkesën e prindërve.

Një nga ndryshimet pozitive që e përshkoi gjysmëvjetorin e parë të këtij viti ishte niveli i lakmueshëm i disiplinës në shkollë, i cili mundësoi zvogëlimin në minimum të problemeve në shkollë.

Vit pas viti, të nxënit në shkollë po realizohet përmes formave të kombinuara me ndihmën e pajisjeve, mjeteve e materialeve të sofistikuara për nxënie të suksesshme, nga mësimi në klasa deri te mësimi kabinetik në të gjitha lëndët e shkencave të natyrës, të Arteve, të shkencave sociale e gjuhësore, mësimi në natyrë, ai nëpër institucione të ndryshme, mësimi përmes projekteve ku nxënësit fitojnë dhe zbatojnë dijet e tyre në praktikë, etj. Këto i ndihmojnë nxënësve të Mil-3 që të krijojnë shprehi të mira për punë dhe të jenë të përgatitur për jetë.

Të nxënit e gjuhës angleze u zbatua me ndryshime në programin e punës (nga komisioni i përbërë nga prindër e arsimtarë), sidomos për klasat 1 dhe 5, që të vazhdohet me programe të reja çdo vit për gjeneratë. Një përparim u arrit te të gjitha klasat e ulëta me shtimin e 1 ore të aktiviteteve në gjuhën angleze përveç 2 orëve të rregullta në javë, në të cilat nxënësit do të zhvillojnë komunikimin përmes skeçeve, këngëve, vjershave e lojërave jashtëmësimore. Vlen të theksohet se që nga tani janë siguruar të gjitha tekstet mësimore të gjuhës angleze për vitin shkollor 2010/11, materialet ndihmëse, kur mendohet që të realizohet i tërë mësimi i anglishtes përmes 6 niveleve në klasat 6-11 nga ai fillestar deri në të nxënit e Toefl-it.

Për të arriturat e shkollës "Mileniumi i Tretë", më së miri flet performanca e nxënësve në aktivitete të ndryshme si prezantime teknologjike dhe praktike të projekteve, punime të ndryshme shkencore, në klasa e korridore, ekspozita të artit, krijime letrare, programe festive, botime informative, etj. Java e parë e Mësimit të Bazuar në Porjekte, këtë vit u realizua në tërë shkollën përnjëherë nga klasa 1-10 dhe prezantimet e tyre u shfaqën para prindërve, kurse nga produktet e projekteve u hap ekspozita 1-javore të cilën e vizituan prindër, gazetarë dhe punonjës arsimi.

Përveç këtyre, sukseset e nxënësve shihen mirëfilli në vlerësimet e ndryshme që përdorin mësimdhënësit për matjen e arritjeve të tyre.

Këtë vit, vazhdoi të rrisë frutat e veta edhe më tepër puna me NVN (nxënësit me vështirësi në nxënie), për arsye se përveç mësimdhënësit mentor, shumë nxënës e patën ndihmën e vazhdueshme nga psikologja (klasat e larta) dhe ndihmëse mësueset, nga një për gjeneratë (klasat e ulëta).

Aktivitetet plotësuese, te klasat e larta, u realizuan sërish përmes blloqeve lëvizëse 1-2 mujore me orar të rregullt duke ia përshtatur kërkesave, nevojave dhe dëshirave të nxënësve për këto aktivitete.

Dy vitet e fundit, puna e rregullt e më se 18 klubeve të shkollës përmbushi në masë të madhe format e të nxënit ekstrakurrikular duke u realizuar çdo të premte pasdite me shpërndarjen e nxënësve sipas dëshirës në to. Këtë vit, edhe te klasat e ulëta u funksionalizuan 8 klube që punuan çdo të enjte e në fund të gjysmëvjetorit performuan me të arriturat e tyre.

Shkolla Mil-3 ka kohë që në kuadër të risive në procesin mësimor, realizon zhvillimin e mësimit në natyrë, në institucione të ndryshme pas përfundimit të temave të planifikuara të HpH-it, gjatë projekteve siç ishte edhe Muzeu Etnografik për njohjen e vlerave kombëtare nga i cili rrodhi filmi i shkurtër nga nxënësit e shkollës me paraqitjen e kulturës shqiptare.

Gjatë muajit të parë u realizua kampi zbavitës për fëmijë me nxënësit e klasave 1-5, nga çka doli edhe ideja e organizatës sportive me seli në Danimarkë që të ftojë në një kamp të tillë 4 nxënës dhe 1 arsimtar të shkollës për qëndrim 5 ditor në Danimarkë në projektin me titull “Fun school’s football” në temën “Things tolk”.

Vlen të përmendet pjesëmarrja garuese e nxënësve të klasave të pesta në nivel shtetëror në projektin e Kosovisionit dy vite radhazi, ku nxënësit e këtyre klasave u shpërblyen me një nga vendet fituese në punimet më të mira të komunës/ Kosovës. Shih për këtë, Shkolla vlerësoi lart punën e tyre dhe përveç klasës fituese, e cila implementon projekt-idenë me shpërblimin e vet, Shkolla këto dy vjet financon edhe nga dy paralele tjera për projekt-idetë e tyre. Festat e Nëntorit dhe ajo e Vitit të Ri u shënjuan me programe festive përmes pikave muzikore, skeçeve të shkurtra dhe skenografisë së shkëlqyeshme të artistëve të vegjël si dhe me ekspozita arti.

Me kuizet e diturisë që organizohen në shkollë herë pas here, i kontribuohet përgatitjeve për vlerësimin e jashtëm në shkollë i cili realizohet javën e fundit të gjysmëvjetorit, gjë që flet për mobilizimin e plotë të nxënësve e mësimdhënësve për plasimin e dijeve të fituara.

Ngritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe të mësimnxënies në shkollë gjatë viteve shkollore i shërbejnë monitorimet dhe përcjellja e vazhdueshme e orëve mësimore nga drejtoria dhe ekspertët e KEC-it, kur shënohen rreth 150 orë monitorimi për gjysmëvjetor me çka krijohet një pasqyrë reale për punën që bëhet në shkollë.

Nxënësit e shkollës, të udhëhequr nga mësimdhënësit dhe këshilli i nxënësve nuk harrojnë të tregojnë performancën e tyre për Ditët e rëndësishme (Dita Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut, Dita e Paqes, Dita e Pleqve, Dita kundër AIDS), të cilat shënjohen me një varg aktivitetesh si ese, poezi, dokumentare të përgatitura nga nxënësit e klubeve, prezantime punimesh në Power-Point si dhe dramë me seancë gjyqësore për respektimin e të drejtave të fëmijës. Me qëllim të vetëdijesimit të nxënësve për sjellje korrekte brenda dhe jashtë shkollës, parandalimit të konflikteve ndër shoqërore te këta fëmijë, shumë shpesh u organizuan ligjërata e debate me psikologen e shkollës, por të cilëve u ndihmon psikologja edhe me trajtime, këshillime e mentorime sipas nevojës vazhdimisht.

Për mbjelljen e humanitetit te fëmijët e shkollës u realizuan 2 aksione humanitare nga vetë nxënësit për familjet skamnore në lagjen periferike të qytetit, në familjen e një profesori të ndjerë, ndërsa për fund-vit Shkolla ndihmoi fëmijët e SOS-fshatit me blerjen e kartolinave uruese nga ta dhe si gjithnjë siguroi 150 dhurata për Vitin e Ri për fëmijët e lagjes krahas dhuratave për të gjithë nxënësit e shkollës dhe fëmijët e stafit.

22. AKTIVITETE TË TJERA

Në vitet 2008 dhe 2009, Qendra për Arsim e Kosovës ka ndërmarrë edhe një varg aktivitetesh të tjera që po prezantojmë në formë të përmbledhur.

1) Trajnimet për mësimdhënës të gjuhës angleze janë organizuar me përkrahjen e Ambasadës së SHBA në vitet 2008 dhe 2009. Këto trajnime rëndom kanë pasur formën e punëtorive informative ose konsultative 1-2 ditësh që janë mbajtur në nivel të regjioneve dhe janë drejtuar nga ekspertë amerikanë. Vet programi i trajnimit është hartuar gjatë vizitës së ekspertëve për t'iu përshtatur deri në maksimum nevojave të mësimdhënësve.

2) Trajnimi i personelit të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për Menaxhimin Ciklik të Projektit është bërë nga KEC në periudhën qershor-dhjetor 2008 me përkrahjen financiare të projektit ISMAFRD financuar nga Bashkimi Evropian. Përfituesit e këtij trajnimi kanë qenë zyrtarë të lartë të MBPZHR, të cilët janë aftësuar për shfrytëzimin e metodave bashkëkohore të trajnimit përmes një programi mjaft kompleks trajnimi që ka zgjatur 6 muaj.

3) Edukimi multikulturor është program trajnimi për mësimdhënës që u zhvillua me përkrahjen financiare të Shoqatës së Arsimimit të të Rriturve në Kosovë, në muajt dhjetor të vitit 2008 dhe korrik të vitit 2009. Gjatë implementimit u hartua programi i trajnimit dhe materialet e trajnimit, si dhe u përfshinë në trajnim një numër i konsiderueshëm i mësimdhënësve të shkollave të mesme të larta.

4) Projekti "Avancimi i komunikimit me prindër në shkollat e Kosovës" është rezultat i një hulumtimi të gjerë për përfshirjen e prindërve në jetën e shkollës, që është bërë në Kosovë në kuadër të një projekti rajonal ku janë përfshirë 539 shkolla fillore të Kosovës. Një nga rekomandimet ka qenë të hartohen procedurat për takime më efektive me prindër.

Kështu që ky projekt ka pas për qëllim avancimin e komunikimit në mes të shkollës dhe prindërve. Objektiva specifike e këtij projekti është të hulumtohet nëse janë të dobishme qasjet e reja metodologjike të komunikimit me prindër për pjesëmarrje më të madhe të prindërve në jetën e shkollës. Për këtë arsye janë zgjedhur 6 shkolla të Kosovës, nga të cilat 3 në vise urbane dhe 3 në vise rurale. Secila shkollë i ka zgjedhur nga dy përfaqësues të shkollës, një nga personeli i shkollës (kryesisht vetë drejtori i shkollës) dhe një nga prindërit, të cilët kanë marrë pjesë në një punëtori dy

ditore ku janë hartuar procedurat dhe metodologjia e re për komunikim me prindër. Gjatë punëtorisë është dakorduar të hartohet metodologjia dhe procedurat për takime individuale me prindër, të cilat nuk janë praktikë e zakonshme në shkollat e Kosovës.

Metodologjia dhe procedurat u janë prezantuar dhe shpërndarë mësimdhënësve të shkollave të përzgjedhura. Nga mësimdhënësit është kërkuar që të mbajnë takime individuale me prindër ku edhe janë monitoruar gjatë këtyre takimeve. Në fund janë mbledhë informata nga mësimdhënësit dhe drejtorët e shkollave të përzgjedhura për bashkëpunimin me prindër në përgjithësi dhe dobishmërinë e takimeve individuale duke e përdorur metodologjinë dhe procedurat e zhvilluara.

5) Cilësia e arsimit në rajonin e Dukagjinit. - Qendra për Arsim e Kosovës në partneritet me organizatat Avsi (Itali) dhe Cesal (Spanjë) gjatë vitit 2009 zhvilluan një hulumtim në rajonin e Dukagjinit, respektivisht në komunat: Pejë, Gjakovë, Klinë, Istog, Rahovec, Junik, Deçan, Malishevë. Në këtë hulumtim janë përfshirë shumica e shkollave të këtyre komunave. Nga shkollat e përzgjedhura në hulumtim kanë marrë pjesë të gjithë mësimdhënësit dhe drejtorët. Për të realizuar këtë hulumtim sa më mirë, si përkrahje logjistike janë përfshirë edhe dy Qendrat Didaktike, ajo e Gjakovës dhe Pejës. Kjo ka ndihmuar që shpërndarje dhe grumbullimi i pyetësorëve të bëhet nga stafi i Qendrave Didaktike.

Numri i përgjithshëm i mësimdhënësve të përfshire në këtë hulumtim është 1277 nga rajoni i Pejës dhe 1492 nga ai i Dukagjinit, ndërsa numri i drejtorëve është 111. Bashkëpunimi i mirë në mes të gjitha palëve të përfshira në këtë hulumtim ka bërë që realizimi i tij të jetë në nivel të kënaqshëm. I gjithë ky projekt ka rezultuar me një raport mjaft voluminoz, me shumë të dhëna dhe me disa rekomandime të cilat iu kanë prezantuar pastaj të gjitha palëve me interes. Përveç këtij raporti, në kuadër të këtij hulumtimi janë organizuar aktivitete me qëllim ngritjen e kapaciteteve të Qendrave Didaktike.

6) Koncepti i qytetarisë te nxënësit e shkollës fillore në Kosovë.- Qendra për Arsim e Kosovës në bashkëpunim me Universitetin e Edukimit në Zurich, (PHZH), dhe me Fakultetin e Edukimit të Universitetit të Prishtinës (FEUP), në tetor të vitit 2009 kanë filluar implemtentimin e një projekti kërkimor. Faza e parë e këtij projekti është: që përmes bashkëpunimit të KEC, PHZH dhe FEUP, të hartohen dhe testohen instrumentet për hulumtimin "Koncepti i qytetarisë te nxënësit e shkollës fillore në Kosovë", ndërsa në fazën e dytë, kur i kemi të gjitha instrumentet e hulumtimit, do të punohet në hartimin e një projekt propozimi, me anë të të cilit mëtohet të zhvillohet një projekt i madh për konceptet e qytetarisë, me nxënësit e shkollave fillore në Kosovë.

Deri me tani është mbajtur punëtoria e parë e përbashkët, ku është prezantuar projekti dhe janë ndarë detyrat e secilit. Gjithashtu, janë zhvilluar edhe disa takime të grupit hulumtues që kanë rezultuar me finalizimin e instrumenteve të hulumtimit, përkatësisht të pyetësorëve. Hapat tjerë të projektit janë: Testimi i këtyre instrumenteve, finalizimi i tyre dhe zhvillimi i projektit final.

23. PËRFUNDIMI

Në prag të dhjetëvjetorit të themelimit të saj, Qendra për Arsim e Kosovës është ndërtuar në një organizatë stabile, e cila zhvillon me sukses aktivitete jofitimprurëse,

por edhe aktivitete ekonomike për të përkrahur këto të parat. Fillimi i vitit 2010 e gjen KEC-in me më shumë se 100 punonjës me perspektivë që ky numër të shtohet si rezultat i fillimit të projekteve të reja dhe zgjerimit të projekteve ekzistuese. Po ashtu, numri i bashkëpunëtorëve të jashtëm është vazhdimisht në rritje si dhe prezenca e programeve të KEC-it në shkollat e Kosovës.

Gjatë viteve 2008 dhe 2009 janë përfshirë në programe trajnimi, jo vetëm mësimdhënës dhe administratorë të arsimit, por edhe struktura të tjera që mund të ndikojnë në ndryshime pozitive në sektorin e arsimit, në veçanti zyrtarë të arsimit të niveleve të ndryshme. Meqë Qeveria është përcaktuar për licencimin e të gjithë mësimdhënësve, pritet që trajnimi në shërbim te zyrtarizohet, duke hapur rrugë për zhvillimin e programeve të reja.

KEC, tanimë ka ndërtuar një partneritet të fuqishëm me institucione dhe organizata relevante brenda Kosovës dhe më gjerë. Kjo dëshmohet përmes pjesëmarrjes së KEC ose personelit të tij në të gjitha ngjarjet me rëndësi për fushën e arsimit, si në Kosovë, ashtu edhe në Rajon. KEC vazhdon të jetë anëtar aktiv i disa rrjeteve të organizatave në nivel të Rajonit, si ISSA dhe NEPC, ndërsa ka zhvilluar projekte rajonale me të dy rrjetet. Partneriteti me Cambridge Education Ltd. ka rezultuar me fillimin e implementimit të një projekti të rëndësishëm për arsimin në Kosovë, ndërsa pritet të bëj të mundur edhe realizmin e kontratave të tjera.

Shkolla “Mileniumi i Tretë” vazhdoi të zhvillohet edhe më tutje, ndërkaq duke filluar prej vitit shkollor 2009/10 zgjeroi veprimin e vet edhe në nivelin e arsimit të mesëm të lartë. Shkolla karakterizohet me një afarizëm relativisht stabil që bën të mundur të sigurohet një zhvillim i vazhdueshëm i saj.